



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 102

Tiranë – E mërkurë, 10 maj 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 53/2017 datë 13.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës.....	5659
Ligj nr. 56/2017 datë 13.4.2017	Për negocimin e marrëveshjes ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “Al Habtoor Investment llc” për projektimin dhe ndërtimin e “Kullës Ikonike” në Tiranë.....	5664
Ligj nr. 57/2017 datë 20.4.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006, “Për inspektimin e punës”, të ndryshuar.....	5665
Ligj nr. 58/2017 datë 20.4.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.....	5667
Ligj nr. 59/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional” .....	5670
Ligj nr. 60/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtim fondesh)”.....	5673
Ligj nr. 61/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe the Swiss Confederation Konfederatës Zvicerane për projektin “Aftësi për punë, faza e parë, 1 tetor 2015 - 28 shkurt 2019” .....	5675

Ligj nr. 62/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit” .....	5679
Ligj nr. 63/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e ndryshimit nr. 7, të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për forcimin e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ratifikuar me ligjin nr. 174/2013.....	5681
Ligj nr. 64/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me aktet ligjore të BE-së” .....	5683
Ligj nr. 65/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik për zbatimin e projektit “Zhvillimi i qëndrueshëm i integruar i rajonit bregdetar” .....	5685
Ligj nr. 66/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për Programin e Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë....	5687
Ligj nr. 67/2017 datë 20.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të gjermanisë për projektin “Ruajtja e agrobiodiversitetit në Shqipërinë rurale” .....	5694



**LIGJ**  
**Nr. 53/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË  
NDRYSHIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË, DUKE VEPRUAR  
NËPËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, DHE TRANS ADRIATIC  
PIPELINE AG, LIDHUR ME  
MARRËVESHJEN ME QEVERINË E  
VENDIT PRITËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10263, datë 4.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**VERSION I SIGLUAR I DATËS**  
**7 DHJETOR 2016**

**MARRËVESHJE NDRYSHIMI**  
**E DATËS 1.3.2017 NDËRMJET**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË QË VEPRON**  
**NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG**  
Në lidhje me Marrëveshjen me Qeverinë e  
Vendit Pritës të datës 5 Prill 2013

**Kjo Marrëveshje lidhet më datë 1.3.2017 ndërmjet:**

**1. Republikës së Shqipërisë** që vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave (Shteti); dhe

**2. Trans Adriatic Pipeline AG**, një shoqëri e organizuar dhe që ekziston në bazë të ligjeve të Zvicrës, me degë të regjistruar në Shqipëri në adresën [Qendra e Biznesit ABA, Zyra Nr. 906, Rruga Papa Gjon Pali II, 1010] Tiranë, regjistruar në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë me nr. regjistrimi K92402023O (Investitori i Projektit dhe së bashku me Shtetin, **Palët**).

**HYRJE**

A) Gjatë vitit 2012, Palët kanë hyrë në bisedime për të lidhur një marrëveshje me qeverinë e vendit pritës në lidhje me Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti) nën supozimin se ndërmjet Republikës së Italisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë do të lidhej dhe nënshkruhej një marrëveshje ndërqeveritare në përputhje me marrëveshjet e qeverive të vendeve pritëse që do të lidheshin nga Investitori i Projektit dhe Republika e Greqisë dhe Republika e Shqipërisë veçmas dhe se marrëveshjet e mësipërme do të depozitoheshin pranë parlamenteve përkatës për ratifikim.

B) Që nga Janari i vitit 2013, as negociimi i MQN-së dhe as negociimi i marrëveshjes së qeverisë pritëse midis Investitorit të Projektit dhe Republikës së Greqisë, nuk kishin përfunduar, dhe Shteti duke u përpjekur të dëshmojë mbështetjen e tij për Projektin, ra dakord që të përfundonte negociimin e MQP me Investitorin e Projektit dhe Palët nënshkruan Marrëveshjen Paraprake më 18 Janar 2018 mbi një format të panëshkruar të marrëveshjes së qeverisë pritëse këtu bashkëlidhur (MP).

C) Qëllimi i MP-së ishte vendosja e bazave mbi të cilat Palët ranë dakord të bëjnë ndryshime në marrëveshjen e qeverisë pritëse për ta bërë të përputhshme për sa i përket disa aspekteve financiare specifike me MQP-në Greke (siç përkufizohet më poshtë) për t'u lidhur ndërmjet Palëve.

D) Ndërsa MQN u nënshkrua më 13 Shkurt 2013, negociimi për MQP-në greke deri në atë moment nuk kishte përfunduar ende, kështu që Shteti, duke u përpjekur të dëshmojë mbështetjen e tij për Projektin dhe në veçanti për të ndihmuar Projektin për t'u përzgjedhur nga Konsorciumi i shoqërive që zotërojnë prodhimin e gazit nga Shah Deniz (SDC) si gazsjellësi i përzgjedhur për transportin e gazit të tyre në tregjet Evropiane, ranë



dakord më 5 prill 2013 për të ekzekutuar një version identik të formatit të panënshkruar të marrëveshjes me qeverinë pritëse bashkëlidhur MP-së dhe më pas për ta paraqitur për ratifikim nga Parlamenti Shqiptar më 15 Prill 2013 (MQP).

E) Në lidhje me nënshkrimin dhe ratifikimin e MQP-së dhe në përpjekje për të ruajtur bazat për ta bërë MQP-në të përputhshme, për për sa i përket disa aspekteve financiare specifike, me marrëveshjen e qeverisë pritëse, e cila do të lidhet ndërmjet Investitorit të Projektit dhe Republikës së Greqisë, Palët gjithashtu nënshkruan një marrëveshje krahasuese më 5 Prill 2013 të cilën Parlamenti Shqiptar e ratifikoi me 15 Prill 2013 (**Marrëveshja Krahasuese**), me synimin që nëse do të ishte e nevojshme, MQP do të ndryshohej nga Palët në përputhje me Marrëveshjen Krahasuese për ta bërë atë të pajtueshme me marrëveshjen e qeverisë pritëse greke, për sa i përket aspekteve specifike financiare (**Ndryshimet e Kërkuara**).

F) Marrëveshja e qeverisë pritëse greke (MQP greke) u lidh me 26 Qershor 2013 dhe u ratifikua nga parlamenti i Republikës greke më 2 Dhjetor 2013 dhe më 28 Qershor 2013 Projekti u përzgjedh nga SDC.

G) Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është zbatimi i detyrimeve të Palëve sipas Marrëveshjes Krahasuese në lidhje me Ndryshimet e Kërkuara.

H) Synohet që kjo Marrëveshje të ratifikohet nga Parlamenti shqiptar.

Kjo Marrëveshje është plotësuese dhe ndryshon MQP-në.

**Është rënë dakord** si më poshtë:

## 1. INTERPRETIMI

### 1.1 Përkufizime

Në këtë Marrëveshje:

**MQP e Ndryshuar** do të thotë MQP e ndryshuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

**Data e Hyrjes në Fuqi** ka kuptimin e dhënë në Nenin 2 (Data e Hyrjes në Fuqi).

**Autorizim i Ndhmës Shtetërore** do të thotë vendimi i autoritetit përkatës, duke përfshirë Komisionin shqiptar të Ndhmës Shtetërore, si dhe çdo autoritet tjetër kombëtar ose Evropian se ndryshimet që do të bëhen nga kjo Marrëveshje në MQP dhe detyrimet e Shtetit sipas MQP-së së ndryshuar nuk përbëjnë ndihmë shtetërore të paligjshme sipas kuptimit të Ligjit Shqiptar ose Nenit 18(1)(c) të Traktatit të Komunitetit të

Energjisë, ose që në rast se këto masa përbëjnë ndihmë shtetërore, kjo ndihmë është në përputhje me Ligjin Shqiptar ose Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

### 1.2 Interpretimi

a) Fjalët me germa të mëdha të përkufizuara në MQP kanë kuptim të njëjtë në këtë Marrëveshje, përveç nëse në të parashikohet ndryshe.

b) Parashikimet e Neneve 1.3 (Interpretimi), 34 (Përgjegjësia ndaj Palëve të Treta), 36 (Heqja Dorë nga Imuniteti), 37 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) dhe 38 (Ligji i Zbatueshëm) i MQP-së zbatohen edhe për këtë Marrëveshje sikur të ishin përcaktuar plotësisht në këtë Marrëveshje përveçse referencat në MQP duhet të konsiderohen si referenca në këtë Marrëveshje.

## 2. DATA E HYRJES NË FUQI

2.1 Pa cenuar dispozitat e Nenit 2.6, hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje është objekt i:

a) nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Palët;

b) miratimit të kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave;

c) Ligjit të Parlamentit të Shtetit që ratifikon këtë Marrëveshje, duke u botuar në Fletoren Zyrtare;

d) Marrjes së Autorizimit të Ndhmës Shtetërore; dhe

e) Datës e Hyrjes në Fuqi në përputhje me Nenin 2.2.

2.2 Nëse secila nga Palët çmon se të gjitha kushtet paraprake e përcaktuara në Nenin 2.1 (përveç kushtit paraprak të përcaktuar në Nenin 2.1(e) janë plotësuar, duhet të njoftojë Palën tjetër. Nëse Pala tjetër bie dakord se të gjitha kushtet paraprake e përcaktuara në Nenin 2.1 (përveç kushtit paraprak të përcaktuar në Nenin 2.1(e) janë plotësuar, duhet të njoftojë me shkrim Palën e parë, data e këtij njoftimi do të jetë Data e Hyrjes në Fuqi. Pa cenuar dispozitat e Nenit 2.6, ne Datën e Hyrjes në Fuqi kjo Marrëveshje do të bëhet efektive dhe do të hyjë në fuqi.

2.3 Menjëherë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, Shteti duhet:

a) të paraqesë këtë Marrëveshje pranë Parlamentit të Shtetit për ratifikim dhe/ose miratim, në mënyrë që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi sipas Kushtetutës si pjesë e Ligjit shqiptar;

b) të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të paraqitur drafte të legjislacionit lejues dhe ligjeve të tjera sipas nevojës për të lidhur këtë Marrëveshje



dhe në veçanti të drejta, garanci, përjashtime, grante, privilegje, standarde, përjashtime dhe dëshmipërblime mbi përgjegjësinë ligjore të zbatueshme për Projektin dhe efektive sipas Kushtetutës ose Ligjit shqiptar;

c) të bëjë përpjekje për të siguruar marrjen e ratifikimeve dhe/ose miratimeve të kësaj Marrëveshjeje, si dhe zbatimin e këtij legjislacioni përpara ose së bashku me ratifikimin dhe/ose miratimin; dhe

d) të bëjë përpjekje për marrjen e Autorizimit të Ndhmës Shtetërore.

2.4 Nëse pavarësisht përpjekjeve të Shtetit, autoriteti kompetent, duke përfshirë Komisionin shqiptar të Ndhmës Shtetërore ose çdo autoritet tjetër kompetent kombëtar ose Evropian, jep Autorizimin e Ndhmës Shtetërore me kusht që kësaj Marrëveshjeje t'i bëhen ndryshime, ose kushte të tjera, vendimi i autoritetit përkatës do të konsiderohet si Autorizim i Ndhmës Shtetërore për qëllim të kësaj marrëveshjeje, nëse këto ndryshime ose kushte pranohen me shkrim nga Investitori i Projektit.

2.5 Shteti duhet që herë pas here dhe me kërkesë të Investitorit të Projektit, t'i përgjigjet me shkrim pyetjeve të Investitorit të Projektit mbi progresin e Shtetit në lidhje me përmbushjen e detyrimeve sipas Nenit 2.3.

2.6 Pavarësisht se kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi, Nenit 2 (Data e Hyrjes në Fuqi), 5 (Përfaqësime dhe Garanci), 6 (Të ndryshme) dhe 7 (Ligji i zbatueshëm) do të bëhen efektive dhe do të fillojnë në datën e kësaj Marrëveshjeje.

### 3. Ndryshimet

a) MQP ndryshohet nga Data e Hyrjes në Fuqi në mënyrën e përcaktuar në Shtojcën 1 (Ndryshime në Marrëveshjen me Qeverinë Pritëse).

b) Ministria e Financave duhet të hartojë një udhëzim për Drejtorinë e Tatimeve mbi zbatimin e drejtë të ndryshimeve të përcaktuara në Shtojcën 1.

### 4. Marrëveshja Krahasuese

Pranohet se në dhe nga Data e Hyrjes në Fuqi (si rezultat i ndodhjes):

a) Palët do të kenë përmbushur detyrimet e tyre sipas Nenit 2 (Ndryshime të kërkuara në MQP pas nënshkrimit dhe/ose miratimit) të Marrëveshjes Krahasuese dhe se nuk do të lindin detyrime të tjera ose të mundshme për të lindur në atë ose pas asaj date, në lidhje me Nenin 2;

b) Palët nuk do kenë asnjë detyrim tjetër si rezultat apo në lidhje me Marrëveshjen Krahasuese për të kryer ndryshime shtesë në MQP, përveç atyre sipas kësaj Marrëveshjeje dhe se nuk do të ketë rrethana në të ardhmen, ndodhja e të cilave mund të shkaktojë lindjen e ndonjë prej këtyre detyrimeve; dhe

c) Marrëveshja Krahasuese do të zgjidhet dhe do të përfundojë efektet e saj.

## 5. Përfaqësime dhe Garanci

### 5.1 Përfaqësime dhe Garanci të Shtetit

Shteti kryen përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në:

a) paragrafët (b) dhe (d) të Nenit 12.1 (Përfaqësime dhe Garanci të Shtetit) të MQP-së mbi Datën e Hyrjes në Fuqi; dhe

b) paragrafët (a) dhe (e) të Nenit 12.1 mbi Datën e Hyrjes në Fuqi dhe përsërit ato përfaqësime dhe garanci në secilën datë të mëpasshme,

në secilin rast duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që do të ekzistojnë në atë moment, si dhe referimi tek MQP është referim në këtë Marrëveshje dhe MQP-në e Ndryshuar.

### 5.2. Përfaqësime dhe Garanci të Investitorit të Projektit

Investitori i Projektit kryen përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në:

a) paragrafët (a) dhe (c) të Nenit 13.1 (Përfaqësime dhe Garanci të Investitorit të Projektit) të MQP mbi Datën e Hyrjes në Fuqi; dhe

b) paragrafët (b) dhe (d) të Nenit 13.1 mbi Datën e Hyrjes në Fuqi dhe përsërit ato përfaqësime dhe garanci në secilën datë të mëpasshme,

në secilin rast duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që do të ekzistojnë në atë moment, si dhe referimi tek MQP është referim në këtë Marrëveshje dhe MQP-në e Ndryshuar.

### 6. Të ndryshme

Në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, MQP do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë.

### 7. Ligji Rregullues

Kjo Marrëveshje dhe detyrimet jashtë-kontraktuale që lindin nga ose në lidhje me të, rregullohen nga Ligji anglez.

**Kjo Marrëveshje** është lidhur në datën e caktuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.



SHTOJCA 1  
 NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN ME  
 QEVERINË PRITËSE

MQP do të ndryshohet si më poshtë:

1. Shtohet një pikë (H) tek parathënia, si më poshtë:

(H) Më [ ] 2017 Palët kanë lidhur një marrëveshje ndryshimi (**Marrëveshja e Ndryshimit**) në lidhje me disa ndryshime në kushtet e kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja e Ndryshimit ka hyrë në fuqi pas plotësimit të kushteve të referuara në nenin 2 (Data e Hyrjes në Fuqi) të kësaj Marrëveshjeje.

2. Fjalët “ndryshimet e ligjit shqiptar që lidhen me taksat, të referuara në nenin 24” hiqen nga paragrafi (d) nga përkufizimi i “Ndryshime të Përbashkëta të Ligjit” në nenin 1.1 (Përkufizime) dhe zëvendësohen me fjalët “çdo ndryshim i Ligjit shqiptar për sa i përket Taksave”.

3. Përkufizimi i “Humbja ose Dëmi” hiqet plotësisht nga neni 1.1 (Përkufizime) dhe ndryshohet si më poshtë:

**Humbja ose Dëmi** do të thotë çdo humbje, kosto dëmtimi, përgjegjësi, shpenzim (duke përfshirë interesat, penalitetet, tarifat e arsyeshme të avokatit dhe pagesa të arsyeshme), pagesa, penalitete apo dëme të pësuar ose të shkaktuara nga një Palë ose Person, duke përfshirë çdo shumë të paguar ose të pagueshme në lidhje me çdo proces gjyqësor, procedime ose pretendime dhe, në lidhje me Investitorin e Projektit, çdo shumë të pagueshme sipas Kontratave të Zbatimit.

4. Përkufizimi i “Kursime nga Taksat” hiqet nga neni 1.1 (Përkufizime).

5. Përkufizimet e mëposhtme shtohen në nenin 1.1 (Përkufizime).

(i) **Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.7(a)(i).

(ii) **Shuma SD e Periudhës së Dytë** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.7(a)(ii).

(iii) **Kodi i Taksave të Periudhës së Dytë** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.5(b).

(iv) **Periudha e Dytë e Taksave** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.5(b).

(v) **Kodi i Taksave të Datës së Nënshkrimit** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.5(a).

(vi) **Të Ardhura të Tatuashme SD** nënkupton se për çdo vit, fitimet e atribuara për Vendosi e Përbashkëta të Projektit të Investitorit në Shtet, e

cila është e tatueshme sipas Ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat nr. 8438 të datës 28 Dhjetor 1998 (në fuqi në Datën e Nënshkrimit) dhe parimeve të kësaj Marrëveshjeje.

(vii) **Viti i Dhjetë DOT** nënkupton 31 Dhjetorin e parë pas dhjetëvjetorit të Datës së Operacioneve Tregtare.

(viii) **Shuma e Paguar e Periudhës së Tretë** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.8(a)(i).

(ix) **Shuma SD e Periudhës së Tretë** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.8(a)(ii).

(x) **Kodi i Taksave të Periudhës së Tretë** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.5(c).

(xi) **Periudha e Tretë e Taksave** ka kuptimin e dhënë në nenin 24.5(c).

(xii) **Data DOT e Vitit të Njëzetë** do të thotë 31 Dhjetori i parë pas përvjetorit të njëzetë të Datës së Operacioneve Tregtare.

(xiii) **Data DOT e Vitit të Njëzet e Pestë** do të thotë 31 Dhjetori i parë pas njëzet e pesë vjetorit të Datës së Operacioneve Tregtare.

6. Shtohet një nen i ri 2.7 si më poshtë:

2.7 Palët pranojnë se pa cenuar dispozitat e Nenit 3.4(b) që nga Data e Hyrjes në Fuqi (sipas Marrëveshjes së Ndryshimit) kjo Marrëveshje e ndryshuar nga Marrëveshja e Ndryshimit është plotësisht në fuqi sipas Kushtetutës dhe Ligjit Shqiptar.

7. Neni 24.5 hiqet dhe nenet e përcaktuara më poshtë shtohen si nene 24.5 – 24.8 të MQP-së, dhe paragrafët e tjerë brenda nenit 24 (Taksat) (dhe çdo referim tjetër në MQP tek ato nene) rinumërohen përkatësisht.

*Zbatimi tek Investitori i Projektit*

24.5 Në bazë të Nenit 24.6 dhe përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe ose lejohet nga kjo Marrëveshje, Ligji i Taksave të Shtetit:

(a) në fuqi në Datën e Nënshkrimit, përveç në lidhje me Normën e TVSH-së (**Kodi i Taksave të Datës së Nënshkrimit**) do të jetë i vlefshëm dhe do të zbatohet tek Investitori i Projektit deri më dhe duke përfshirë Datën e DOT të Vitit të Dhjetë;

(b) në fuqi në datën pas Datës DOT të Vitit të Dhjetë, përveç në lidhje me Normën e TVSH-së (**Kodi i Taksave të Periudhës së Dytë**) do të jetë e vlefshme dhe do të zbatohet tek Investitori i Projektit nga dita e nesërme e Datës DOT të Vitit të Dhjetë, deri më dhe duke përfshirë Datën DOT të Vitit të Njëzetë (**Periudha e Dytë e Taksave**); dhe



(c) në fuqi në ditën e nesërme pas Datës DOT të Vitit të Njëzetë, përveç në lidhje me Normën e TVSH-së (**Kodi i Taksave të Periudhës së Tretë**), do të jetë e vlefshme dhe do të zbatohet tek Investitori i Projektit nga dita e nesërme e Datës DOT të Vitit të Njëzetë, deri dhe duke përfshirë Datën DOT të Vitit të Njëzet e Pestë (**Periudha e Tretë e Taksave**),

në secilin rast, duke përjashtuar të gjitha Taksat e tjera gjatë periudhës përkatëse.

24.6 Pa cenuar parashikimet e pjesës tjetër të Nenit 24 ose Nenit 32, Investitori i Projektit duhet të respektojë Ligjin e Taksave të Shtetit, të ndryshuar herë pas here, në lidhje me përqindjen e TVSH-së.

24.7 Për çdo vit të Periudhës së Dytë të Taksave:

(a) Investitori i Projektit duhet që brenda 30 ditësh pas depozitimit të deklarimit të të ardhurave vjetore në lidhje me vitin përkatës, të pajisë Shtetin me një raport ku përcaktohen:

(i) të gjitha Taksat që janë paguar nga Selia e Përhershme në Shtet gjatë atij viti në Përputhje me Kodin e Taksave të Periudhës së Dytë (**Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë**);

(ii) të gjitha Taksat që duhet të ishin paguar nga Selia e Përhershme në Shtet gjatë atij viti, nëse Kodi i Taksave të Datës së Nënshkrimit do të ishte hartuar (**Shuma SD e Periudhës së Dytë**); dhe

(iii) një krahasim midis Shumës së Paguar të Periudhës së Dytë dhe Shumës SD të Periudhës së Dytë; dhe

(b) nëse në lidhje me vitin përkatës:

(i) Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë është më pak se Shuma SD e Periudhës së Dytë me më shumë se 5.2 % të SD, Investitori i Projektit duhet t'i paguajë Shtetit shumën që është në kalim të kufirit 5.2% brenda 60 ditësh nga data e raportit të Investitorit të Projektit sipas Nenit 24.7(a); ose

(ii) Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë është më e madhe se Shuma SD e Paguar e Periudhës së Dytë me më shumë se 5.2% të të Ardhurave të Tatueshme SD, Shteti duhet t'i paguajë Investitorit të Projektit shumën që është në kalim të kufirit 5.2% brenda 60 ditësh nga data e raportit të Investitorit të Projektit sipas Nenit 24.7(a).

24.8 Për secilin vit të Periudhës së Tretë të Taksave:

(a) Investitori i Projektit duhet që brenda 30 ditësh pas depozitimit të deklarimit të të ardhurave

vjetore në lidhje me vitin përkatës, të pajisë Shtetin me një raport ku përcaktohen:

(i) të gjitha Taksat që janë paguar nga Selia e Përhershme në Shtet gjatë atij viti në përputhje me Kodin e Taksave të Periudhës së Tretë (**Shuma e Paguar e Periudhës së Tretë**);

(ii) të gjitha Taksat që duhet të ishin paguar nga Selia e Përhershme në Shtet gjatë atij viti, nëse Kodi i Taksave të Datës së Nënshkrimit do të ishte hartuar (**Shuma SD e Periudhës së Tretë**); dhe

(iii) një krahasim midis Shumës së Paguar të Periudhës së Tretë dhe Shumës SD të Periudhës së Tretë; dhe

(b) nëse në lidhje me vitin përkatës:

(i) Shuma e Paguar e Periudhës së Tretë është më pak se Shuma SD e Periudhës së Tretë me më shumë se 5.2% të të Ardhurave të Tatueshme SD, Investitori i Projektit duhet t'i paguajë Shtetit shumën që është në kalim të kufirit 5.2% brenda 60 ditëve nga data e raportit të Investitorit të Projektit sipas Nenit 24.8(a); ose

(ii) Shuma e Paguar e Periudhës së Tretë është më e madhe se Shuma SD e Paguar e Periudhës së Tretë me më shumë se 5.2% të të Ardhurave të Tatueshme SD, Shteti duhet t'i paguajë Investitorit të Projektit shumën që është në kalim të kufirit 5.2% brenda 60 ditëve nga data e raportit të Investitorit të Projektit sipas Nenit 24.8(a).

8. Fjalë e parë e Nenit 24.18 zëvendësohet me fjalët "Pa kufizuar zbatimin e Nenit 43, parashikimi i Nenit 24 do të mbetet në fuqi deri më dhe do të përfshijë Datën DOT të Vitit të Njëzet e Pestë".

9. Nenet 30.2, 30.3 dhe 30.6 hiqen plotësisht.

10. Në paragrafin (b) të Nenit 32.2 hiqen fjalët hyrëse "Bazuar në paragrafin (c) me poshtë".

11. Paragrafi (c) i Nenit 32.2 hiqet.

12. Neni 32.3 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

### **32.3 Ndryshime të Ligjit që mundësojnë Kursime**

Nëse si rezultat i Ndryshimit të Ligjit, Investitori i Projektit është i aftë të realizojë Kursime në lidhje me Projektin, dhe Investitori i Projektit (në gjykimin e tij) realizon faktikisht Kursime, atëherë Investitori i Projektit, nëse do të kërkohet me shkrim nga Shteti (kjo kërkesë do të bëhet jo më vonë se një vit nga data që ka ndodhur Ndryshimi përkatës i Ligjit), do të kompensojë Shtetin me gjysmën e këtyre Kursimeve. Ky kompensim, nëse Shteti e kërkon, do të paguhet në Monedhën e



Konvertueshme dhe sipas gjykimit të Investitorit të Projektit, do të jetë në formën e:

(a) rimbursimit të Shtetit për gjysmën e Kursimeve të realizuara nga Investitori i Projektit si rezultat i Ndryshimit të Ligjit, menjëherë pasi këto Kursime janë realizuar; ose

(b) përveç në rastin e Kursimeve Tatimore, rimbursimit tek Shteti i gjysmës së Kursimeve të realizuara nga Investitori i Projektit si rezultat i Ndryshimit të Ligjit, në formën e pagesave të barabarta vjetore ndaj Shtetit gjatë pjesës së mbetur të kohëzgjatjes së pritshme të Projektit. Në këtë rast, këto pagesa do të rëndohen me interes me Normën e Rënë Dakord të Interesit. Ky interes do të zbatohet nga data(t) kur këto Kursime janë realizuar nga Investitori i Projektit deri në datën/datat kur janë kryer pagesat ndaj Shtetit.

13. Paragrafi i parë i Shtojcës 5 zëvendësohet me fjalët “Në përputhje me Nenin 24, pranimet dhe konfirmimet e mëposhtme për zbatimin e Ligjit Shqiptar që lidhet me Taksat në përputhje me referencat ligjore të dhëna më poshtë deri më Datën DOT të Vitit të Dhjetë dhe çdo zëvendësim dhe ndryshim i tyre që hyn në fuqi pas asaj date, bihen dakord nga Palët”.

## **NËNSHKRUESIT**

### **KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SHQIPËRISË**

Nga: Ilir Bejtja  
Pozicioni: Deputy Minister

### **INVESTITORI I PROJEKTIT**

Trans Adriatic Pipeline AG  
Nga: Shkëlqim Bozgo  
Pozicioni: Country Manager

## **LIGJ Nr. 56/2017**

### **PËR NEGOCIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR DHE KOMPANISË “AL HABTOOR INVESTMENT LLC” PËR PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E “KULLËS IKONIKE” NË TIRANË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

### **Neni 1 Objekti**

Ky ligj përcakton procedurën për negocimin e marrëveshjes ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “Al Habtoor Investment LLC” për projektimin dhe ndërtimin e “Kullës Ikonike” në Tiranë.

### **Neni 2 Procedura e negocimit**

1. Procedura e negocimit të marrëveshjes të ndiqet nga Komisioni i Negocimit të Marrëveshjes, i cili kryesohet nga një përfaqësues i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ka në përbërje përfaqësues edhe nga Ministria e Financave, Bashkia e Tiranës dhe Avokatura e Shtetit.

2. Komisioni i Negocimit të Marrëveshjes të fillojë negociatat me kompaninë “Al Habtoor Investment LLC” për propozimin e paraqitur prej tyre, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 3 Miratimi i marrëveshjes**

1. Komisioni i Negocimit të Marrëveshjes, në përfundim të procedurave të negocimit harton një raport, të cilin ua dërgon për shqyrtim Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministrit të Financave.

2. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministri i Financave, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së raportit, shprehen nëse janë dakord me propozimet e paraqitura.

3. Nëse ata nuk janë dakord, ia kthejnë Komisionit të Negocimit të Marrëveshjes, me vërejtjet përkatëse.

4. Nëse ata janë dakord, vijojnë procedurat për propozimin e akteve të miratimit në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend.





Neni 4  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Ilir Meta**

Miraturar në datën 13.4.2017

**LIGJ**  
**Nr. 57/2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË LIGJIN NR. 9634, DATË 30.10.2006,  
“PËR INSPEKTIMIN E PUNËS”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006, “Për inspektimin e punës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “kontrollor pune” hiqet.

Neni 2

Neni 2 riformulohet si më poshtë:

“Neni 2

**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Inspektorat” është inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës, organizimi dhe funksionimi i të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. “Inspektim në punë” është çdo formë kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas legjislacionit të punës, i bërë nga inspektorati, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

3. “Legjislacioni i punës” janë:

a) konventat e ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

b) ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

c) ligji nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar;

ç) ligji nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar;

d) ligji nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

dh) ligji nr. 108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar;

e) i gjithë legjislacioni që ngarkon Inspektoratin e Punës për sigurimin e zbatueshmërisë së tyre;

ë) aktet nënligjore në zbatim të shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 3, të këtij neni.”.

4. “Ministër” është ministri, i cili mbulon çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin e punës.

5. “Person fizik”, “Person juridik” apo “Subjekt” është çdo person fizik apo juridik, sipas përcaktimit të bërë në Kodin Civil.

6. “Inspektor pune” është inspektori i inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e punës.”.

7. “Mirëqenie në punë” janë të gjitha lehtësitë sociale që duhet t’u krijojë punëdhënësi punëmarrësve, si: shërbimi i ushqimit, shërbimi i shëndetit në punë, shërbimi i kohës së lirë, shërbimi i transportit të punëmarrësve, si dhe shërbimi i personelit.

8. “Kushte pune” janë elementet që lidhen me mjedisin, në të cilin një punëmarrës ushtron veprimtarinë e vet, si dhe elementet sociale e administrative, të tilla si pagat, kohëzgjatja e punës, puna e natës, pushimi javor dhe ai vjetor.

9. “Degë e veprimtarisë ekonomike” është çdo degë, ku punësohet punëmarrësi, përfshirë dhe shërbimin publik.

10. “Punësim informal” është një marrëdhënie punësimi që nuk u nënshtrohet, si nga ana ligjore, ashtu edhe në praktikë, kërkesave të legjislacionit të punës dhe ligjit për procedurat tatimore dhe ku punëmarrësi nuk përfiton të drejtat e tij, që burojnë nga këto ligje.

11. “Aksesueshmëri e personave me aftësi të kufizuar” është mënjanimi i pengesave sociale, mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në vendin e punës.”.



## Neni 3

Në nenin 13, pika 6 shfuqizohet.

## Neni 4

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 7, pas fjalëve “gjatë procesit të punës” shtohen fjalët “në përputhje me ligjin për inspektimin”.

b) Pika 9 shfuqizohet.

## Neni 5

Neni 15 riformulohet si më poshtë:

“Neni 15

**Mjetet e ndërhyrjes në rastin e shkeljeve të legjislacionit të punës**

Inspektori, me qëllim përmirësimin e gjendjes dhe shmangien e shkeljeve të dispozitave ligjore, të cilat i janë ngarkuar për zbatim inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e punës, procedon administrativisht, në përputhje me ligjin për inspektimin:

1. Për respektimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës e të punësimit për detyrimin e punëdhënësit:

a) për të përfunduar me shkrim kontratën individuale të punës, për ata punëmarrës që nuk e kanë një dokument të tillë në çastin e kontrollit, dhe kontratën kolektive;

b) për korrigjimin e atyre neneve të kontratës individuale, të cilat parashikojnë kushte më të disfavorshme se ato të parashikuara në legjislacionin dhe kontratën kolektive të punës;

c) për të paraqitur dokumentin e degës përkatëse të tatimeve për deklarimin dhe pagesën e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore e shëndetësore për të gjithë punëmarrësit;

ç) për të respektuar punësimin e personave me aftësi të kufizuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) për të respektuar punësimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, grave shtatzëna dhe nënave të reja;

dh) për detyrimet e parashikuara në ligj për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit;

e) për detyrimet ligjore për punën e natës;

ë) për të respektuar pajisjen me leje pune për punëmarrësit e huaj, në përputhje me ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”;

f) për respektimin e pagës minimale, të miratuar nga Këshilli i Ministrave;

g) për të paraqitur dokumentet e deklarimit të punëmarrësve të punësuar dhe të larguar rishtazi, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

gj) për respektimin e lirive dhe të drejtave sindikale.

2. Për respektimin e dispozitave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve për detyrimin e punëdhënësit:

a) për marrjen e lejes nga inspektori i punës para vënies në punë të ndërmarrjes ose të një pjese të saj, në përputhje me Kodin e Punës;

b) për riparimin e defekteve që vërehen gjatë funksionimit të pajisjeve apo përdorimit të metodave të punës, për të cilat inspektori vlerëson se ka shkaqe të arsyeshme dhe se ato përbëjnë një kërcënim për shëndetin apo sigurinë e punëmarrësve;

c) për kryerjen e kontroleve teknike të instalimeve të aparaturave e të makinerive;

ç) për modifikimin e instalimeve të nevojshme brenda një afati të caktuar kohor;

d) për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar në vendin e punës, sipas ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, dhe akteve nënligjore të tij.

Ministri përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë nxjerr udhëzimin për detyrimet që kanë subjektet publike dhe private për zbatimin e kësaj shkronje.”.

## Neni 6

Neni 16 shfuqizohet.

## Neni 7

Neni 19 riformulohet si më poshtë:

“Neni 19

Inspektori i punës duhet të respektojë Kodin e Etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë.”.

## Neni 8

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 4 shfuqizohet.

b) Pika 5 riformulohet si më poshtë:

“5. Punëdhënësi duhet të marrë leje nga Inspektorati i Punës para vënies në punë të ndërmarrjes apo të një pjese të saj, si dhe për çdo



ndryshim teknologjie prodhimi, për mënyrën e organizimit të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 9

Neni 25 riformulohet si më poshtë:

“Neni 25

### **Detyrimet e punëmarrësit**

Punëmarrësi respekton urdhrat dhe udhëzimet e punëdhënësit për masat e sigurisë e të shëndetit në punë, përdor të gjitha pajisjet e punës dhe mjetet mbrojtëse individuale, si dhe merr pjesë aktive në formim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 10

Në kreun V bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i kreut ndryshohet si më poshtë:

“Detyrimi i inspektoratit për informim dhe këshillim”.

b) Titulli i nenit 26 ndryshohet si më poshtë:

“Informimi dhe këshillimi”.

Neni 11

Në nenin 33 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, shkronja “b” riformulohet si më poshtë:

“b) për shkelje të dispozitave të legjislacionit të punës, përjashtuar ato të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, inspektori i punës vendos gjobë nga 10 deri në 50-fishin e pagës minimale, sipas parimit të proporcionalitetit, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

b) Në pikën 2, pas fjalëve “Për shkelje” shtohen fjalët “të parashikuara në nenin 35, të këtij ligji.”.

c) Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Kur inspektori i punës kundërshtohet apo pengohet në kryerjen e detyrës, subjekti sanksionohet në masën nga 10 000 deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 12

Neni 35 riformulohet si më poshtë:

“Neni 35

### **Masa urgjente**

1. Inspektori i punës vendos masën urgjente, në përputhje me ligjin për inspektimin:

a) në rastet e konstatimit të punësimit informal;

b) në rast se vazhdimi i aktivitetit përbën rrezikshmëri të menjëhershme, të rëndë, të paevitueshme për sigurinë e shëndetit e punëmarrësve dhe është i nevojshëm evakuimi i tyre nga vendi i punës.

2. Marrja e masës urgjente ose vendosja e saj si dënim plotësues bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

3. Ankimi ndaj vendosjes së masës urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 13

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10264, datë 4.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**

**Nr. 58/2017**

### **PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 108/2014, “PËR POLICINË E SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 hiqen fjalët “ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë”.

Neni 2

1. Në nenin 6 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) pika 15 shfuqizohet;

b) pas pikës 29 shtohen pikat 30 dhe 31 me këtë përmbajtje:



“30. “Vërtetimi i besueshmërisë” është dokument i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, i cili pasqyron rezultatet e verifikimit të të dhënave të vetëdeklaruar në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të policisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, që lëshohet nga autoritetet vendore të Policisë së Shtetit, për shtetasin/personin, i cili pranohet apo rikthehet në Policinë e Shtetit.

31. “Policimi vullnetar” është ofrimi vullnetar i shtetasve, në ndihmë të Policisë së Shtetit për ruajtjen e rendit, qetësisë publike, parandalimin e krimit dhe përballimin e situatave të emergjencave civile.”

2. Kudo në ligj:

a) Fjalët “Drejtor i Policisë së Shtetit” zëvendësohen me fjalët “Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit”.

b) Fjalët “Zëvendësdrejtor i Policisë së Shtetit” zëvendësohen me fjalët “Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit”.

c) Fjalët “Drejtorja e Policisë së Shtetit” zëvendësohen me fjalët “Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”.

ç) Fjalët “Akademi e Policisë” zëvendësohen me fjalët “Akademi e Sigurisë”.

d) Fjalët “komision gradimi” zëvendësohen me fjalët “komision vlerësimi”.

Neni 3

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

### **Drejtori i departamentit**

1. Drejtori i departamentit është autoritet i lartë, që drejton një departament, i cili është strukturë organizative në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Drejtori i departamentit përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për veprimtarinë e departamentit që drejton.

3. Përshkrimi i punës dhe përgjegjësitë e drejtorit të departamentit miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

4. Numri i drejtorive të departamentit përcaktohet në varësi të strukturës organizative të Policisë së Shtetit, e cila miratohet nga ministri.

5. Emërimi, kriteret e emërimit, lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtorit të departamentit

janë të njëjta me ato të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

6. Drejtori i departamentit qëndron në detyrë për një periudhë prej 4 vjetësh, me të drejtë riemërimi edhe për 4 vjet të tjera.”

Neni 4

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, në fund të fjalisë shtohen fjalët “dhe i jep gradën “Drejtues madhor””;

2. Në pikën 3, fjalët “për një mandat tjetër” zëvendësohen me fjalët “për 5 vjet të tjera”.

Neni 5

Në nenin 14, pika 2, fjalët “për një mandat tjetër” zëvendësohen me fjalët “për 4 vjet të tjera”.

Neni 6

Në nenin 16 bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) humbet shtetësinë shqiptare”.

2. Në pikën 3, fjala “vendim” zëvendësohet me fjalën “urdhër”.

Neni 7

Në nenin 17, shkronja “h” shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 19, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit organizohet në struktura organizative hierarkike në nivel departamenti, drejtorie dhe sektori.”

Neni 9

Neni 22 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 37, pika 2, pas fjalës “ofron” shtohet fjala “formim”.

Neni 11

Në nenin 38 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) të jetë pajisur me vërtetimin e besueshmërisë.”



## 2. Pika 3 shfuqizohet.

## Neni 12

Në nenin 40, pika 2, hiqet fjalia “Përfshihen nga ky rregull punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët vijnë nga radhët e prokurorëve në detyrë”.

## Neni 13

Në nenin 43 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Punonjësi i policisë, gjatë periudhës 1-vjeçare të provës, nuk transferohet, me përjashtim të rasteve të veçanta të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.”.

2. Në pikën 3, fjalët “me gradën “Inspektor”” zëvendësohen me fjalët “të rolit zbatues”.

## Neni 14

Pas nenit 50 shtohet neni 50/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/1

**Hierarkia e menaxhimit policor**

Gradat në polici ndahen në role, sipas kompetencës së veprimit dhe nivelit të menaxhimit, si më poshtë:

a) në rolin zbatues, ku përfshihen punonjësit e policisë që mbajnë gradën “Inspektor”, “Inspektor i dytë”, dhe “Inspektor i parë”, që përfaqësojnë nivelin bazë të veprimit policor;

b) në rolin e parë drejtues, ku përfshihen punonjësit e policisë që mbajnë gradën “Nënkomisar”, “Komisar” dhe “Kryekomisar”, që përfaqësojnë nivelin taktik të drejtimit dhe veprimin teknik operacional;

c) në rolin e mesëm drejtues, ku përfshihen punonjësit e policisë që mbajnë gradën “Drejtues” dhe “Drejtues i parë”, që përfaqësojnë nivelin e menaxhimit ekzekutiv qendror dhe/ose vendor;

ç) në rolin madhor, ku përfshihen punonjësit e policisë që mbajnë gradën “Drejtues i lartë” dhe “Drejtues madhor”, që përfaqësojnë nivelin e menaxhimit strategjik.”.

## Neni 15

Në nenin 51, pika 1, pas shkronjës “a” shtohen shkronjat “a/1” dhe “a/2” me këtë përmbajtje:

“a/1) Inspektor i dytë;

a/2) Inspektor i parë.”.

## Neni 16

Në nenin 53 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Marrja e gradës”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Gradat “Inspektor i dytë” dhe “Inspektor i parë”, për punonjësit e policisë që plotësojnë afatin e qëndrimit në gradë, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, jepen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit mbi bazën e vjetërsisë në punë, trajnimeve dhe kualifikimeve.”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Punonjësi i policisë që mban gradën “Drejtues i lartë”, pas përfundimit të afatit të qëndrimit në detyrë, merr gradën “Drejtues i parë”.

## Neni 17

Në nenin 55 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronjat “ç” dhe “d” shfuqizohen.

2. Në shkronjën “ë”, nën-pika “i” ndryshohet si më poshtë:

“i) nga “Inspektor” deri në “Inspektor i dytë”, 5 vjet;

i/1) nga “Inspektor i dytë” deri në “Inspektor i Parë”, 10 vjet;”.

i/2) punonjësit të policisë në rolin zbatues, që ka vjetërsi shërbimi mbi 5 vjet, i lind e drejta për të konkurruar për fitimin e gradës “Nënkomisar.”

## Neni 18

Në nenin 67, pika 2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”.

## Neni 19

Në nenin 76, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, parandalimin e krimit dhe përballimin e situatave të emergjencave civile, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me komunitetin, organizon policimin vullnetar. Organizimi, funksionimi dhe fusha e veprimit të policimit vullnetar rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

## Neni 20

Në nenin 112, pika 3, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:



“c) mostra për nxjerrjen e profilit të ADN-së.”.

Neni 21

Në nenin 138 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 shfuqizohet.
2. Në pikën 4, fjalët “pikat 1 dhe 2” zëvendësohen me fjalët “pikën 1”.

Neni 22

Në nenin 142 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:  
“5. Punonjësi që është në periudhë prove, pavarësisht nga marrja e gradës “Inspektor”, periudha 1-vjeçare e provës i fillon nga momenti që ka përfunduar arsimin policor.”.
2. Pika 7 shfuqizohet.

Neni 23

#### **Dispozitë kalimtare**

Afati i qëndrimit në detyrë për drejtorin e departamentit fillon pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 24

#### **Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 19, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 25

#### **Hyrja në fuqi**

1. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji fillojnë nga data 1 janar 2018 dhe përballohen nga Buxheti i Shtetit.

2. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10265, datë 4.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**

**Nr. 59/2017**

### **PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK PËR PROJEKTIN “ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK DHE RAJONAL, NXITJA E PUNËSIMIT DHE ARSIMI PROFESIONAL”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10266, datë 4.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

I nderuar zoti Ambasador,

Kam nderin t'i referohem notës tuaj të datës 26 shtator 2016, nr. Wi 445 TZ 129, e cila citon:

Zoti Ministër

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke ju referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 si dhe në zbatim të marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik mes Gjermanisë dhe Shqipërisë të datës 21 tetor 1988,



t'ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi Bashkëpunimin Teknik :

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesin së bashku projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional , nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin në fjalë me shpenzimet e saj, kontribute personeli dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 5.500.000 Euro (me fjalë: pesë milionë e pesëqind mijë euro). Ajo do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset, që institucioni i ngarkuar prej tij me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e larpërmendur.

5. Hollësitë e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhen të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit dhe do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakort për këtë.

7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat – pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 – do të

mbarojë më datë 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licensat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksa të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha tatimet dhe taksat publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhë gjermane dhe në gjuhë shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy Qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoni, zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

I nderuar zoti Ambasador

Kam nderin të konfirmoj në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për sa është propozuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe bie dakord që nota e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo notë në përgjigje të saj do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga pala gjermane të njoftimit të shkruar nga pala shqiptare, për përfundimin e procedurave të nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Pranoni zoti Ambasador sigurimet e konsideratës më të lartë

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME  
**Ditmir Bushati**



AMBASADORI  
I REPUBLIKËS FEDERALE  
TË GJERMANISË

Numri i dosjes : Wi 445 TZ 129  
Tiranë, më 26 Shtator 2016

Zoti Ministër,

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 si dhe në zbatim të marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik të datës 21 tetor 1988, t'ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi Bashkëpunimin Teknik :

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesin së bashku projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional , nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t’u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin në fjalë me shpenzimet e saj, kontribute personeli dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 5.500.000 Euro (me fjalë: pesë milionë e pesëqind mijë euro). Ajo do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset, që institucioni, i cili do të ngarkohet nga ai me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e lartpërmendur.

5. Hollësitrat e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhen të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Kontrata do t’u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakort për këtë.

7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat – pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 – do të mbarojë më datë 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licensat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksa të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhë gjermane dhe në gjuhë shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy Qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoni, zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

Shkëlqesisë së Tjij  
Ministrit të Punëve të Jashtme  
të Republikës së Shqipërisë  
Zotit Ditmir Bushati  
Tiranë





**LIGJ**  
**Nr. 60/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
ME SHKËMBIM NOTASH NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE  
TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN  
TEKNIK PËR PROJEKTIN “ZHVILLIMI I  
QËNDRUESHËM EKONOMIK DHE  
RAJONAL, NXITJA  
E PUNËSIMIT DHE ARSIMI  
PROFESIONAL (SHTIM FONDESH)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtim fondesh)”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10267, datë 4.5.2017  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

Nr. 3973/3

I nderuar zoti Ambasador,

Kam nderin t'i referohem notës tuaj të datës 23 janar 2017, nr. Wi 445 TZ 131, e cila citon:

Zoti Ministër

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 dhe premtimit të Ambasadës

së Republikës Federale të Gjermanisë (Nota verbale nr. 349/2016, datë 29 nëntor 2016) si dhe në zbatim të marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik mes Gjermanisë dhe Shqipërisë të datës 21 tetor 1988, t'ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi Bashkëpunimin Teknik:

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesin së bashku projektin “Zhvillim i qëndrueshëm dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtim fondesh)”, nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për shtimin e fondeve në projektin në fjalë, kontribute personeli dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 5 000 000 Euro (me fjalë: pesë milionë euro). Kësisoj e tërë vlera e projektit “Zhvillim i qëndrueshëm dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional” arrin në 10 500 000 Euro (me fjalë: dhjetë milionë e pesëqind mijë euro). Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset, që institucioni i ngarkuar prej tij me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e larpërmendur.

5. Hollësitë e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhen të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Kontrata do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakort për këtë.



7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat – pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 – do të mbarojë më dt. 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licencat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksa të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhë gjermane dhe në gjuhë shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy Qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoni, zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

I nderuar zoti Ambasador

Kam nderin të konfirmoj në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përsa është e propozuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe bie dakord që nota e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo notë në përgjigje të saj do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në përfundimin e marrjes nga pala gjermane të njoftimit të shkruar nga pala

shqiptare, për përfundimin e procedurave të nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Pranoni zoti Ambasador sigurimet e konsideratës më të lartë

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME  
**Ditmir Bushati**

AMBASADORI  
I REPUBLIKËS FEDERALE  
TË GJERMANISË

Numri i dosjes : Wi 445 TZ 131  
Tiranë, më 23 Janar 2017

Zoti Ministër,

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 dhe premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (Nota verbale nr. 349/2016, datë 29 nëntor 2016) si dhe në zbatim të marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik mes Gjermanisë dhe Shqipërisë të datës 21 tetor 1988, t'ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi Bashkëpunimin Teknik:

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesin së bashku projektin “Zhvillim i qëndrueshëm dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional (shtim fondesh)”, nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për shtimin e fondeve në projektin në fjalë, kontribute personeli dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 5 000 000 Euro (me fjalë: pesë milionë euro). Kësisoj e tërë vlera e projektit “Zhvillim i qëndrueshëm dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional” arrin në 10 500 000 Euro (me fjalë: dhjetë milionë e pesëqind mijë euro). Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).



4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset, që institucioni i ngarkuar prej tij me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e larpërmendur.

5. Hollësitrat e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhen të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Kontrata do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakort për këtë.

7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat – pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 – do të mbarojë më dt. 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licensat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksat të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhë gjermane dhe në gjuhë shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të

barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy Qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoni, zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

Shkëlqesisë së Tij  
Ministrit të Punëve të Jashtme  
të Republikës së Shqipërisë  
Zotit Ditmir Bushati  
Tiranë

**LIGJ**  
**Nr. 61/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS  
ZVICERANE PËR PROJEKTIN “AFTËSI  
PËR PUNË, FAZA E PARË, 1 TETOR 2015 -  
28 SHKURT 2019”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për projektin “Aftësi për punë, faza e parë, 1 tetor 2015- 28 shkurt 2019”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10268, datë 4.5.2017  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**



**MARRËVESHJE  
NDËRMJET KONFEDERATËS  
ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA  
AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM  
DHE BASHKËPUNIM DHE  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË  
MBI PROJEKTIN E AFTËSISË PËR PUNË**

**Faza 1, 2015 – 2019**

Në një përpjekje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis dy vendeve,

Në vijim të Marrëveshjes Kuadër lidhur me Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Ndhimës Humanitare ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë Shqiptare, më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 9801 të datës 13 shtator 2007,

Në respektim të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut - siç janë të përcaktuara sidomos në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut që frymëzon politikën e brendshme dhe të jashtme të të dy Palëve dhe përfaqëson një element thelbësor në të njëjtin qëndrim me objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (që më poshtë do i referohemi si “SDC”) kanë rënë dakord mbi termat dhe kushtet që janë shprehur më poshtë:

Neni 1

**Përkufizimet kryesore**

Kudo që është përdorur në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti kërkon ndryshe, termat në vijim do të kenë kuptimet si më poshtë:

a) “Palët Kontraktuese” nënkupton Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane;

b) “Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë” nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;

c) “Konfederata Zvicerane” përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Konfederatës Zvicerane;

d) “Projekt” nënkupton Projektin e Aftësisë për Punë;

e) “SDC” nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

f) “Grant” nënkupton kontributin e dhënë nga Konfederata Zvicerane sipas kësaj Marrëveshjeje;

g) “Partneri Zbatues” nënkupton Swisscontact,

Neni 2

**Përgjegjësia për Zbatim**

Autoritetet e mëposhtme do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Marrëveshjes:

Për Konfederatën Zvicerane:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e përfaqësuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri.

Për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë:

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

SDC-ja do t'i besojë Partnerit Zbatues për zbatimin e Projektit. Partneri zbatues u përzgjedh bazuar në një procedurë të hapur tenderimi, që u krye sipas rregullave dhe rregulloreve të prokurimit publik të Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme.

Neni 3

**Qëllimet dhe Objektivat**

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është: Të rinjtë në Shqipëri përfitojnë nga edukimi dhe trajnimet e përforcuara të orientuar drejt tregut të punës në sektorët me potencial në rritje, duke i mundësuar atyre të gjejnë një punë tërheqëse dhe dinjitoze.

Rezultatet specifike të këtij Projekti janë si më poshtë:

a) Të rinjtë përdorin programet e edukimit dhe trajnimit formal dhe joformal të orientuara drejt tregut, që ofrohen në bazë të mënyrave të reja të të nxëniet gjithëpërfshirës në sektorët e Turizmit & Mirëpritjes, Ndërtimit, Tekstileve dhe TIK.

b) Sektori privat luan një rol të përforcuar në bashkëpunim me ofruesit e përzgjedhur për zhvillimin e aftësive profesionale për ofrimin, sensitiv ndaj përkatësisë gjinore, e zhvillimit të aftësive profesionale në qarqet e Lezhës, Vlorës dhe Beratit.

Për të arritur këto objektiva, Projekti do të bashkëpunojë me institucionet e mëposhtme:



- Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Agjencinë Kombëtare AFP [VET], sektorin privat, shoqatat e biznesit.

Ndërhyrjet, aktivitetet kryesore dhe rezultatet e parashikuara janë përcaktuar në Dokumentin e Projektit. Përmbledhja e Dokumentit të Projektit përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje (Shtojca 1).

#### Neni 4

##### **Detyrimet e Palëve Kontraktuese**

Detyrimet specifike të Konfederatës Zvicerane përfshijnë:

a) Deri më 30 qershor 2019, Konfederata Zvicerane synon të parashikojë fonde në formë të një granti të parimbursueshëm në vlerën maksimale prej CHF 6'300'000 (gjashtë milionë dhe treqind mijë franga zvicerane), i cili do të përdoret në mënyrë ekskluzive për zbatimin e projektit sipas qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara më sipër në Nenin 3.

b) Ky grant nuk mund të alokohet për ndonjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grantit, e cila do të mbetet në fund të projektit, është subjekt i rifinancimit të FDFA-së të Konfederatës Zvicerane;

c) Konfederata Zvicerane, përmes SDC-së, ka kontraktuar Partnerin Zbatues si organizatë zbatuese;

d) Granti do të shpërndahet dhe auditohet sipas dispozitave të kontratës midis SDC-së dhe Partnerit Zbatues.

Detyrimet specifike të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfshijnë:

a) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të veprojë si bashkë-përgjegjëse për strategjinë e projektit;

b) Do të sigurojë lidhjen e Projektit me politikën kombëtare dhe kornizën ligjore përkatëse për Projektin, me qëllim mundësimin dhe promovimin e koherencës së objektivave të Projektit me kushtet e kornizës kombëtare;

c) Mbështesë lehtësimin dhe shpërndarjen e eksperiencës dhe të informacionit bazuar mbi rezultatet e arritura dhe ndikimet e Projektit në nivel kombëtar;

d) Mbështesë dhe lehtësojë lidhjen dhe bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera;

e) Sigurojë reagimin dhe bashkëpunimin e strukturave të decentralizuara në nivel rajonal dhe/ose vendor;

f) Të vërë në dispozicion alokimet e nevojshme buxhetore për të rimbursuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për Projektin për një shumë maksimale prej CHF 600'000 (gjashtëqind mijë franga zvicerane); Rimbursimet e TVSH-së do të kryhen mbi baza vjetore;

g) Këshilli i Ministrave do t'ju krijojë mundësinë ekspertëve të huaj, të angazhuar në bazë të kësaj marrëveshjeje si edhe familjarëve të tyre, të përjashtohen nga të gjithë taksat gjatë vlefshmërisë të kësaj Marrëveshjeje, sipas Nenit 4.1, pika b të marrëveshjes ndërmjet Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndihmën Humanitare.

#### Neni 5

##### **Menaxhimi i Projektit**

a) Projekti është një ndërmarrje e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe SDC-së përmes Ambasadës Zvicerane;

b) Ky Partner Zbatues merr përsipër në emër të Konfederatës Zvicerane të gjitha detyrat operacionale, administrative dhe supervizuese të Projektit, duke përfshirë rimbursimet, monitorimin dhe raportimin;

c) SDC mund të mandatojë ekspertë vendorë dhe të huaj afatgjatë dhe afatmesëm për të mbështetur zbatimin e Projektit;

d) SDC mund të mandatojë individë të tjerë dhe organizata vendore ose ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve të veçanta të Projektit, si për shembull për kontrollin gjatë gjysmës së projektit, dhe për vlerësimin në përfundim të projektit;

e) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë merr të gjithë veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të rëna dakord të Projektit; ofron akses ndaj informacionit përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore të cilat janë të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit.

#### Neni 6

##### **Supervizimi dhe Koordinimi**

Në mënyrë që të sigurohet supervizimi, cilësia, lidhja dhe koordinimi i Projektit si dhe për të trajtuar çështjet e politikave, do të ngrihet një



Komitet Drejtues (KD) dhe takimet do të mbahen dy herë në vit (zakonisht në prill dhe shtator). KD do të arrijë kuorumin vetëm kur të jenë të pranishëm përfaqësuesit e të dy Palëve. Vendimet arrihen përmes konsensusit të të gjithë anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote. Nëse nuk mund të arrihet konsensus do të fillojë një proces negociimi. SDC rezervon të drejtën për vendimin përfundimtar.

KD do të përbëhet nga institucionet e mëposhtme, me nga një votë për secilin:

- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,
- Ambasada e Zvicrës në Shqipëri;
- Ekspertë të mirënjohur në fushën e aftësisë dhe punës;
- Përfaqësues nga sektori privat.

Të tjerë ftohen si vëzhgues (Ministri të tjera, OJF dhe projekte të ngjashme) në bazë të axhendës, pa të drejtë vote.

Sekretariati i Komitetit Drejtues ofrohet nga Projekti. Menaxheri i Projektit merr pjesë në takim pa të drejtë vote.

KD do të ndërmarrë detyrat e mëposhtme:

a) Ofrimin e këshillimit, orientimit dhe rekomandimeve operacionale, teknike dhe strategjike për Ekipin e Projektit lidhur me fushat e ndërhyrjes së Projektit, qasjet metodologjike dhe instrumentet.

b) Ofrimin e Komenteve për Planin Vjetor të Operacioneve (YPO).

c) Këshillimin e Ekipit të Projektit mbi synimet tematike dhe gjeografike, ose mbi objektivat për zhvillimin e instrumenteve të Projektit, në bazë të informacioneve të Raporteve të monitorimit të Ekipit të Projektit.

d) Rishikimin e dokumenteve strategjike, raporteve dhe planeve vjetore dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme.

Mund të kërkohet të mbahet një takim i paprogramuar me kërkesë të njërit prej anëtarëve të KD-së. Takimet bashkë-drejtohen nga Palët.

Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën, deri në nivel të arsyetueshëm të praktikueshëm, do të konsultohen me njëra-tjetrën, lidhur me çdo ngjarje që ndërhyrës ose kërcënon të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të Projektit.

Neni 7

### Prokurimi i Mallrave dhe Shërbimeve

a) Mallrat dhe shërbimet që do të financohen përmes të ardhurave të kontributit zviceran, do të prokurohen në përputhje me rregullat e Partnerit Zbatues të cilat janë bashkërenduar me legjislacionin zviceran për prokurimet publike; Në përputhje me vlerat e pragut, disa lloje prokurimesh mund të bëhen në nivel vendor;

b) Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, mallrat e përfituara nga fondet e SDC-së për përdorim të Projektit do të qëndrojnë në dispozicion të pakufizuar të Projektit dhe nuk do të devijohen nga Projekti pa një aprovim paraprak me shkrim nga SDC-ja;

c) Nëse për ndonjë arsye Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara përmes kontributit zviceran do të vendoset me shkrim nga Palët;

d) Në fund të Projektit, SDC duhet të vendosë mbi pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar gjatë kohës së zbatimit të Projektit;

e) Mallrat e prokuruar nga Projekti për organizatat partnere do t'i dorëzohen dhe do të merren përsipër nga autoriteti përkatës kompetent me aprovimin e SDC-së.

Neni 8

### Përfundimi i Marrëveshjes

a) Secila Palë ka të drejtë të përfundojë Marrëveshjen aktuale përmes një njoftimi me shkrim gjashtë muaj para përfundimit.

b) Nëse njëra nga Palët gjykon se Marrëveshja aktuale nuk mund të arrihet më ose që Pala tjetër Kontraktuese nuk po përmbush detyrimet e saj, Pala tjetër do të ketë të drejtën të anulojë ose përfundojë Marrëveshjen aktuale duke i dhënë një njoftim me shkrim tre muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo Palë mund të përfundojë Marrëveshjen aktuale me efekte të menjëhershme në rast të ndonjë shkelje të konsiderueshme të Marrëveshjes. Shkelje e konsiderueshme nënkupton shkelje të rëndë të një prej objektiveve të rëndësishëm të marrëveshjes aktuale.

c) Në rast se ngjarjet nga forca madhore (katastrofa natyrore etj.) pengojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, secila Palë mund të përfundojë Marrëveshjen që hyn në fuqi që nga momenti kur bëhet i pamundur vazhdimi i saj.



d) Në rast të një përfundimi të parakohshëm të Marrëveshjes aktuale ose në fund të Projektit, çdo fond i pashpenzuar i ofruar brenda strukturës së Projektit, do t'i kthehet SDC-së.

Neni 9

#### **Modifikimet dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Çdo modifikim ose ndryshim i Marrëveshjes aktuale duhet të bëhet me shkrim me pëlqimin e të dy Palëve.

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin ose aplikimin e dispozitave të Marrëveshjes aktuale do të zgjidhen përmes negociatave diplomatike midis Palëve.

Neni 10

#### **Dispozitat e Përgjithshme**

Brenda strukturës së kësaj Marrëveshje, Palët nuk duhet të propozojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime të çfarëdo lloji natyre. Ato nuk duhet të pranojnë ndonjë kërkesë të tillë. Çdo sjellje korruptuese ose e paligjshme nënkupton një shkelje të Marrëveshjes aktuale dhe justifikon përfundimin e saj si dhe/ose marrjen e masave korrigjuese në përputhje me legjislativonin e aplikueshëm.

Neni 11

#### **Shtojcat**

Përmbledhja e Dokumentit të Projektit (Shtojca 1) përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

#### **Kohëzgjatja dhe efikasiteti**

Marrëveshja aktuale mbulon periudhën, duke përfshirë fazën e hartimit dhe atë kryesore, nga 1 tetori 2015 deri më 28 shkurt 2019. Do të hyjë në fuqi mbas ratifikimit në Parlamentin Shqiptar dhe do të përfundojë sapo të dy Palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale përkatëse.

Kjo Marrëveshje është shkruar në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Të dy versionet e teksteve janë autentike dhe kanë të njëjtën vlerë. Në rast të ndryshimeve në interpretim, do të mbizotërojnë versioni në gjuhën angleze.

Palët e mëposhtme konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të përpiluar në Berne më 31 Mars 2017.

Në emër të  
Konfederatës Zvicerane:  
Manuel Sager  
Ambasador  
Drejtor i Përgjithshëm i  
Agjencisë Zviceriane  
për Zhvillim dhe  
Bashkëpunim

Në emër të Këshillit  
të Ministrave të  
Republikës së  
Shqipërisë:  
Olta Xhaçka  
Ministër  
Ministër i Mirëqenies  
Sociale dhe Rinisë

### **LIGJ**

**Nr. 62/2017**

## **PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR PROJEKTIN “MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE TË NGURTA DHE EKONOMIA RICIKLUESE NË RESPEKT TË MJEDISIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10269, datë 4.5.2017  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**



Nr. 4435

Tiranë më 30.3.2017

E nderuar zonja Ambasadore,

Kam nderin t'i referohem notës tuaj të datës 26 shtator 2016, nr. Wi 445 TZ 128, e cila citon:

Zoti Ministër,

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 dhe premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë si dhe në zbatim të marrëveshjes mbi bashkëpunimin teknik mes Gjermanisë dhe Shqipërisë të datës 21 tetor 1988, t'ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi bashkëpunimin teknik:

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesin së bashku projektin "Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit në Shqipëri", nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për shtimin e fondeve në projektin në fjalë, kontribute personeli dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi gjithsej 3 000 000 euro (me fjalë: tre milion euro). Ajo do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset që institucioni i ngarkuar prej tij me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e lartpërmendur.

5. Hollësitë e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhen të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin

e projektit. Kontrata do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakord për këtë.

7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat - pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 - do të mbarojë më datë 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licencat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksa të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi bashkëpunimin teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhë gjermane dhe në gjuhë shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohej dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëhere kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoni, Zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.





E nderuar zonja Ambasadore,

Kam nderin të konfirmoj në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përsa është propozuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe bie dakord që nota e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo notë në përgjigje të saj do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga pala gjermane të njoftimit të shkruar nga pala shqiptare, për përfundimin e procedurave të nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Pranoi zonja Ambasadore sigurimet e konsideratës më të lartë

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME  
Ditmir Bushati

LIGJ  
Nr. 63/2017

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR. 7, TË MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS, QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRIJJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË, TË QËNDRUESHME DHE GJITHËPËRFSHIRËSE, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 174/2013**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi nr. 7, i marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për forcimin e shtetit të së drejtës, qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike

me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ratifikuar me ligjin nr. 174/2013, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10270, datë 4.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

Marrëveshje Granti e USAID-it nr. 182 –  
DOAG – 13 - 010

**NDRYSHIMI NUMËR SHTATË  
I MARRËVESHJES SË GRANTIT PER  
OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET  
QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA  
TË AMERIKËS DHE KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË PËR FORCIMIN E SHTETIT TË  
SË DREJTËS DHE QEVERISJEN E MIRË;  
DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË  
RRIJJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË  
DHE TË QËNDRUESHME  
DATË: 30 SHTATOR 2013**

Ndryshimi Numër Shtatë i Marrëveshjes së Grantit për Objektiva Zhvillimi ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ("USAID") dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (në vijim i referuar si "Përfituesi i Grantit")

Neni 1

**Qëllimi i Ndryshimit**

Ky Ndryshim Numër Shtatë i Marrëveshjes së Grantit të USAID-it për Objektiva Zhvillimi, të datës 30 shtator 2013, ("Marrëveshja") bëhet ndërmjet USAID-it dhe Përfituesit të Grantit ("Palët), me qëllim që (a) të shtojë Gjashtë Milion e Treqind e Pesëdhjetë e Tre Mijë e Dyqind e Gjashtëdhjetë e Pesë dollarë amerikanë ("USD") (6,353,265 \$) të shumës së detyruar, duke rritur kështu kontributin total të llogaritur të USAID-it



nga 33,672,037 \$ në 40,025,302 \$ dhe, (b) të shtojë totalin e kontributit të USAID për periudhën 2013 - 2018 në Gjashtëdhjetë Milion dollarë amerikanë (\$60,000,000).

### Neni 3

#### Kontributet e Palëve

Neni 3, Seksioni 3.1(a) dhe (b) i Marrëveshjes fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

“Seksioni 3.1 Kontributi i USAID-it

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e Objektivave të përcaktuara në këtë Marrëveshje, USAID, në përputhje me Aktin e Ndhmës së Huaj të vitit 1961, të ndryshuar, i jep Përfituesit të Grantit, sipas kushteve të Marrëveshjes, një shumë që nuk kalon Dyzetë Milion e Njëzetë e Pesë Mijë e Treqind e Dy dollarë amerikanë (40,025,302 \$) (“Granti”).”

b) Kontributi total i llogaritur i USAID-it. Kontributi total i llogaritur i USAID-it për arritjen e objektivave do të jetë Gjashtëdhjetë Milion

dollarë amerikanë (60,000,000 \$), të cilat do të jepen në mënyrë shtuese dhe në bazë të disponueshmërisë së fondeve. Rritjet pasuese do të jenë të kushtëzuara nga disponueshmëria e fondeve të USAID-it për këtë qëllim dhe mund të jepen nga USAID-i pas njoftimit me shkrim të dërguar Përfituesit të Grantit. Palët bien dakord që çdo kontribut shtesë i dhënë, sipas rastit, do të rritë në mënyrë kumulative shumën totale të Grantit të përcaktuar në Seksionin 3.1 (a). Pas kësaj Përfituesi i Grantit bie dakord të konfirmojë, me anë të njoftimit me shkrim të dërguar USAID-it, këtë kontribut shtesë, nëse ka.

### Shtojca 1

#### Seksioni III: Plani i mit

Plani i Financimit sipas Shtojcës 1, Përshkrimi të Zgjeruar, Seksioni III, fshihet tërësisht, dhe teksti i mëposhtëm e zëvendëson atë:

#### “III. PLANI I FINANCIMIT

Plani financiar për kryerjen e Objektivave dhe të Rezultateve, paraqitet në tabelën më poshtë:

Nr.	Fusha e Programit	Detyrime të mëparshme	VF 2016	Detyrime aktuale	Totali i Rishikuar i Llogaritur për VF 2013- 2018
1	Shteti Ligjor dhe të Drejtat e Njeriut	7,289,000	\$1,750,000	\$9,039,000	13,500,000
2	Qeverisja e Mirë	14,082,662	\$2,911,000	\$16,993,662	25,000,000
3	Shoqëria Civile	460,000		\$460,000	1,000,000
4	Tregtia dhe Investimet	500,000		\$500,000	1,000,000
5	Sektori Financiar	2,410,000	\$515,000	\$2,925,000	4,000,000
6	Konkurrenshëmëria e Sektorit Privat	5,130,084	\$377,265	\$5,507,349	8,500,000
7	Infrastruktura	0		\$0	
8	Mbështetja për programin	2,800,291	\$800,000	\$3,600,291	6,000,000
9	Mundësia Ekonomike	1,000,000		\$1,000,000	1,000,000
	<b>TOTALI</b>	<b>33,672,037</b>	<b>\$6,353,265</b>	<b>\$40,025,302</b>	<b>60,000,000</b>

### Neni 4

#### Gjuha e Ndryshimit

Ky Ndryshim është përgatitur në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast paqartësie ose konflikti midis dy versioneve, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

### Neni 5

#### Termet dhe Kushtet e Tjera

Përveç sa ndryshuar këtu, të gjitha termet dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes mbeten plotësisht

në fuqi. Të gjitha termet me germa kapitale në këtë Ndryshim Numër Shtatë do të kenë kuptimet që u jepen në Marrëveshje.

**Në dëshmi të kësaj**, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Përfituesi i Grantit, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë marrë masa që ky Ndryshim Numër Shtatë i Marrëveshjes të nënshkruhet në emër të tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.



QEVERIA E  
SHTETEVE TË  
BASHKUARA TË  
AMERIKËS

KËSHILLI I MINISTRAVE I  
REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË

Nr. 3973/1

I nderuar zoti Ambasador,

Kam nderin t'i referohem notës tuaj të datës  
26 shtator 2016, nr. Wi 445 TZ 127 e cila citon:

Zoti Ministër,

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së  
Republikës Federale të Gjermanisë, duke iu  
referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare  
të datës 12 korrik 2016 si dhe në zbatim të  
marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik të  
datës 21 tetor 1988, t'ju propozoj marrëveshjen e  
mëposhtme mbi bashkëpunimin teknik:

1. Qeveria e Republikës Federale të  
Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës  
së Shqipërisë do të mbështesin së bashku  
projektin “Mbështetje për harmonizimin e  
legjislacionit ekonomik dhe tregtar me aktet  
ligjore të BE-së”, nëse nga shqyrtimi përkatës  
rezulton se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë  
në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën  
e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të  
Gjermanisë vë në dispozicion për projektin në  
fjalë, me shpenzimet e saj, kontribute personeli  
dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute  
financimi në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 1  
000 000 euro (me fjalë: një milion euro). Ajo do  
të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë  
Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar  
(Deutsche Gesellschaft für Internationale  
Zusammenarbeit; GIZ).

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së  
Shqipërisë garanton një planifikim të vetin  
buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme  
klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojnë  
zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe  
kujdeset që institucioni, i cili do të ngarkohet nga  
ai me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet  
e nevojshme për projektin e lartpërmendur.

5. Hollësitrat e projektit dhe të shërbimeve dhe  
detyrimeve, që duhen të kryhen, do të  
përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe  
eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet  
ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të  
ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës  
së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Kontrata  
do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në

Nga: \_\_\_\_\_ Nga: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_ Datë: \_\_\_\_\_

Emri: Catherine Emri: Arben Ahmetaj

Johnson

Pozicioni: Përfaqësuesi i Pozicioni: Ministër i Financave  
USAID/Shqipëri

## LIGJ

Nr. 64/2017

### **PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJE PËR HARMONIZIMIN E LEGJISLACIONIT EKONOMIK DHE TREGTAR ME AKTET LIGJORE TË BE-SË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe  
121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e  
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash  
ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së  
Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të  
Gjermanisë për projektin “Mbështetje për  
harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar  
me aktet ligjore të BE-së”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në  
Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10271, datë 4.5.2017  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**



fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakord për këtë.

7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat - pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 - do të mbarojë më datë 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licencat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksat të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi bashkëpunimin teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhë gjermane dhe në gjuhë shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoi, Zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

I nderuar Ambasador,

Kam nderin të konfirmoj në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për sa është propozuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe bie dakord që nota e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo notë në përgjigje të saj do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga pala gjermane të njoftimit të shkruar nga pala shqiptare, për përfundimin e procedurave të nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje.

Pranoi Zoti Ambasador sigurimet e konsideratës më të lartë.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME  
**Ditmir Bushati**

Ambasadori  
i Republikës Federale të Gjermanisë  
Numri i dosjes: Wi 445 TZ 127  
Tiranë, më 26 Shtator 2016

Zoti Ministër,

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke ju referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 si dhe në zbatim të marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik të datës 21 tetor 1988, t'ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi Bashkëpunimin Teknik:

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesin së bashku projektin "Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me aktet ligjore të BE-së", nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin në fjalë me shpenzimet e saj, kontribute personeli dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 1 000 000 euro (me fjalë : një milion euro). Ajo do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).



4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset, që institucioni, i cili do të ngarkohet nga ai me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e larpërmendur.

5. Hollësitrat e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhen të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Kontrata do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakort për këtë.

7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat – pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 – do të mbarojë më datë 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licensat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksat të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhë gjermane dhe në gjuhë shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy Qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoi, zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

Shkëlqesisë së Tij  
Ministrit të Punëve të Jashtme  
të Republikës së Shqipërisë  
Zotit Ditmir Bushati  
Tiranë

**LIGJ**  
**Nr. 65/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE  
TË GJERMANISË, PËR  
BASHKËPUNIMIN TEKNIK PËR  
ZBATIMIN E PROJEKTIT “ZHVILLIMI I  
QËNDRUESHËM I INTEGRUAR I  
RAJONIT BREGDETAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për zbatimin e projektit “Zhvillimi i qëndrueshëm i integruar i rajonit bregdetar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesë përbërëse e tij.



## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10272, datë 4.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

Ambasadori  
i Republikës Federale të Gjermanisë  
Numri i dosjes: Wi 445 TZ 125  
Tiranë, më 26 Shtator 2016

Zoti Ministër,

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke ju referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 si dhe në zbatim të marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik të datës 21 tetor 1988, t'ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi Bashkëpunimin Teknik :

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesin së bashku projektin “Zhvillimi i qendrushëm i integruar i rajonit bregdetar jugor”, nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t’u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin në fjalë me shpenzimet e saj, kontribute personeli dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 1 000 000 euro (me fjalë: një milion euro). Ajo do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset, që institucioni, i cili do të ngarkohet nga ai me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e lartpërmendur.

5. Hollësitrat e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhen të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Kontrata do t’u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakort për këtë.

7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat – pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 – do të mbarojë më datë 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licensat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksat e tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohej dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbejnë një



marrëveshje ndërmjet dy Qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoi, zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

Shkëlqesisë së Tij  
Ministrit të Punëve të Jashtme  
të Republikës së Shqipërisë  
Zotit Ditmir Bushati  
Tiranë

**LIGJ**  
**Nr. 66/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
ZHVILLIMIT URBAN, DHE QEVERISË SË  
KONFEDERATËS ZVICERANE,  
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA  
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE  
BASHKËPUNIM, PËR PROGRAMIN E  
ZHVILLIMIT RAJONAL PËR  
SHQIPËRINË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10273, datë 4.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
ZHVILLIMIT URBAN DHE  
KONFEDERATËS ZVICERANE  
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA  
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE  
BASHKËPUNIM MBI PROGRAMIN E  
ZHVILLIMIT RAJONAL PËR SHQIPËRINË**

**Faza 3, 2017-2018**

Në një përpjekje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis dy Vendeve,

Në vijim dhe sipas Marrëveshjes Kuadër lidhur me Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndhimën Humanitare ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë Shqiptare, të nënshkruar më 11 maj 2007,

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat themelore të njeriut - siç janë të përcaktuar sidomos në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut - frymëzon politikën e brendshme dhe të jashtme të të dy Palëve dhe përfaqësojnë një element thelbësor në të njëjtin pozicion me objektivat e kësaj Marrëveshje.

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (që më poshtë do i referohemi si “SDC”), kanë rënë dakord mbi termat dhe kushtet që janë shprehur më poshtë:

**Neni I**

**Kushtet e Përgjithshme dhe Përkufizimet**

Kudo që është përdorur në këtë Marrëveshje, përveçse kur konteksti kërkon ndryshe, termat në vijim do të kenë kuptimin si më poshtë:

a) “Palët Kontraktuese” nënkuptojnë Këshillin e Ministrave të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatën Zvicerane;

b) “Konfederata Zvicerane” përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

c) “SDC” nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme, e cila përfaqësohet në Shqipëri nga Ambasada Zvicerane;



d) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përfaqësohet nga Ministria e Zhvillimit Urban;

e) “ADA” nënkupton Agjencinë Austriake për Zhvillim, e cila është bashkëfinancuese e Projektit;

f) “Projekt” nënkupton Programin e Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë, Faza 3, e financuar nga SDC dhe ADA;

g) “Partner zbatues” nënkupton agjencinë që është kontraktuar pas një tenderi ndërkombëtar të hapur nga SDC dhe që ka detyrën e zbatimit të Projektit.

### Neni II

#### Përgjegjësia për Zbatim

1. Ministria e Zhvillimit Urban do të jetë agjencia bashkëpunuese e Projektit.

2. SDC do të jetë Autoriteti Zbatues për aplikimin e Marrëveshjes dhe zbatimin e Projektit. SDC do t'i delegojë përgjegjësitë zbatuese Ambasadës Zvicerane.

3. ADA është bashkëfinancuese e Projektit. ADA dhe SDC kanë rënë dakord përmes një Marrëveshje Bashkëpunimi të Deleguar që t'i japin SDC-së pozicionin e donatorit drejtues të Projektit. SDC do të administrojë kontributet (e SDC dhe ADA-s) dhe do të ndjekë Projektin për Vendin Partner dhe Agjencinë Zbatuese.

4. SDC do t'i besojë Ecorys, të përzgjedhur përmes një tenderi ndërkombëtar të hapur nga një komision i përbashkët vlerësues të përbërë nga SDC, ADA dhe Qeveria Shqiptare, zbatimin e Projektit.

### Neni III

#### Qëllimet dhe Objektivat

1. Synimi i përgjithshëm i Projektit është që të ulë pabarazitë në Shqipëri, duke mbështetur zhvillimin e rajoneve të fuqishme, të cilët do të forcojnë potencialet e tyre dhe do të ofrojnë kushte më të mira sociale dhe ekonomike për qytetarët e tyre.

2. Objektivat kryesore të Projektit janë:

a) Qeveria qendrore përcakton, bashkërendon dhe zbaton me sukses kornizën ligjor dhe institucional për Zhvillimin Rajonal.

b) Institucionet e reja për Zhvillimin Rajonal përdorin në mënyrë efikase dhe strategjike fondet e shtuara për zhvillimin e rajoneve përmes një qasjeje me bazë partneritetin.

Faqe | 5688

c) Kushtet sociale dhe ekonomike për qytetarët që jetojnë në Shqipëri janë përmirësuar përmes zbatimit të projekteve të Zhvillimit Rajonal të mbështetura në nevojat dhe prioritetet rajonale.

Për të arritur këto objektiva, Projektit do të bashkëpunojë me institucionet e mëposhtme:

- Ministrinë e Zhvillimit Urban, Zyra e Kryeministrit, Ministrinë e Linjës, Agjencia Kombëtare Rajonale për Zhvillimin Rajonal, Agjencitë për Zhvillimin Rajonal, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, Njësitë e Qeverisjes Vendore, Shoqata e Bashkive, Shoqata e Autonomisë Vendore, Shoqata e Qarqeve, përfaqësues nga shoqëria civile dhe sektori privat, partnerët për zhvillim dhe palë të tjera të interesuara në fushën e Zhvillimit Rajonal.

Zërat kryesorë të ndërhyrjeve janë përmbledhur në Përshkrimin e Projektit te Aneksi 1.

### Neni IV

#### Fusha dhe Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Marrëveshja do të mbulojë aktivitetet e shprehura në Përshkrimin e Projektit, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje. Kjo marrëveshje mbulon fazën 3 të programit, 1.4.2017 – 30.9.2018.

### Neni V

#### Përgjegjësitë e SDC-së

a) Kontributi zviceran - austriak është një grant dhe do të përdoret për zbatimin e aktiviteteve të Projektit, ashtu siç shprehen në Përshkrimin e Projektit, i cili përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje;

b) Granti për fazën 3 arrin shumën në 3'445'000 CHF.

c) Ky grant nuk mund të alokohet për ndonjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grantit, e cila do të mbetet në fund të projektit, është subjekt i kthimit të parave të SDC-së;

d) Administron fondet e Projektit përmes Ambasadës Zvicerane;

e) Ofron fonde për prokurimin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, në përputhje me aktivitetet e rëna dakord nga Palët.

### Neni VI

#### Përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Urban

Ministria e Zhvillimit Urban do të:

a) vërë në dispozicion alokimet e nevojshme





buxhetore për të rimbursuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për Projektin për një shumë maksimale prej CHF 380'000 (treqind e tetëdhjetë mijë franga zvicerane);

#### Neni VII

##### Menaxhimi i Projektit

Projektin është një ndërmarrje e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, SDC-së dhe ADA-s përmes Ambasadës Zvicerane;

Nga ana zvicerane:

- SDC është përgjegjës për zbatimin e përgjithshëm të Projektit.

- SDC mund të mandatojë ekspertë vendorë dhe të huaj afatgjatë dhe afatmesëm për të mbështetur zbatimin e Projektit.

- SDC mund të mandatojë individë të tjerë dhe organizata vendorë ose ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve të veçanta të Projektit.

Nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Urban:

- Është bashkëpërgjegjëse për drejtimin e Projektit;

- Ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të rena dakord për Projektin;

- Ofron kapacitetet për të ndihmuar partnerin zbatues për pjesë të ndryshme të Projektit;

- Ofron qasje ndaj informacionit përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore që mendohet se janë të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni do të përdoret vetëm për qëllimet e Projektit. Çdo përdorim tjetër do t'i nënshtrohet lejes me shkrim të dhënë paraprakisht nga Ministria e Zhvillimit Urban.

#### Neni VIII

##### Mbikëqyrja dhe Bashkërendimi

1. Në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrja dhe bashkërendimi i Projektit, si dhe për të trajtuar çështjet e politikave, do të ngrihet një Komitet Drejtues Projektit (KDP) dhe takimet do të mbahen dy herë në vit. KDP do të arrijë kuorum vetëm kur përfaqësuesit e të dy Palëve Kontraktuese janë të pranishëm dhe kur vendimet arrihen përmes konsensusit.

2. KDP-ja do të përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm me të drejtë vote:

a) 1 përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban (bashkëkryetar i KDP-së)

b) 1 përfaqësues nga Ambasada Zvicerane (bashkëkryetar i KDP-së);

c) 1 përfaqësues nga Agjencia Austriake e Zhvillimit;

d) 1 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Zhvillimit Rajonal (drejtor);

e) 1 përfaqësues nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal (mbi bazë rotacioni).

Anëtarët e mëposhtëm do të kenë statusin e vëzhguesit në Komision:

f) Përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit; Ministria e Çështjeve Vendorë; Ministria e Financave; Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministri të tjera të linjës dhe agjenci shtetërore;

g) Përfaqësues nga institucione përfituese (Agjencitë e Zhvillimit Rajonal; Agjencia Kombëtare e Zhvillimit Rajonal);

h) Përfaqësues nga donatorë të tjerë të interesuar në këtë fushë (si p.sh. BE);

i) Përfaqësues nga Njësitë e Qeverisjes Vendorë të interesuara dhe Shoqatat e tyre, dhe përfaqësues nga Qarqet dhe Shoqatat e tyre.

Vëzhguesit nuk kanë të drejtë vote.

Në bazë të nevojës dhe temës për diskutim, mund të ftohen aktorë të tjerë për të marrë pjesë në rolin e vëzhguesve.

Sekretariati i Komitetit Drejtues të Projektit ushtrohet nga Partneri Zbatues. Drejtuesi i Projektit merr pjesë në takim pa të drejtë vote.

3. KDP do të ndërmarrë detyrat e mëposhtme:

a) Të shqyrtojë dhe diskutojnë ecurinë lidhur me të gjitha aspektet e reformës rajonale për zhvillim dhe të ndarjes së informacionit mbi politikat;

b) Të identifikojë, diskutojnë dhe propozojë zgjidhje për probleme të mundshme të zhvillimit rajonal në Shqipëri dhe masat e nevojshme;

c) Të mbështesë Projektin dhe të ofrojë udhëzime për gjetjen e zgjidhjeve për problemet e rëndësishme të zbatimit;

d) Të zgjidhë mosmarrëveshjet që mund të shfaqen gjatë zbatimit të Projektit;

e) Të shqyrtojë dhe miratojnë raportin vjetor të ecurisë së projektit;

f) Të ofrojë *feedback* mbi planin e aktiviteteve që i është paraqitur Ambasadës Zvicerane;

4. Mund të kërkohet të mbahen takime të paprogramuara me kërkesë të njërit prej anëtarëve të Komitetit. Takimet thirren nga kryetari i Komitetit.



5. Një Komitet Teknik mund të organizohet mbi baza *ad-hoc* për të mbështetur dhe bashkërenduar planifikimin dhe zbatimin e projektit.

Komiteti Teknik ka në përbërje përfaqësues në nivel teknik, si më poshtë:

a. 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban;

b. 1 (një) përfaqësues nga Departamenti i Zhvillimit dhe Ndihmës së huaj pranë Zyrës së Kryeministrit;

c. 1 (një) përfaqësues nga Ambasada Zviceriane;

d. 1 (një) përfaqësues nga Agjencia Austriake e Zhvillimit;

e. Drejtuesi i Projektit.

Komiteti Teknik do të garantojë ndjekjen nga afër të projektit dhe të performojë çështjet e mëposhtme:

a. Mbështesi në çdo hap procesin e planifikimit dhe zbatimin të projektit;

b. Të drejtojë diskutimet teknike në të gjithë çështjet e rëndësishme;

c. Të aprovojë produktet kryesore të projektit;

d. Të orientojë zbatimin e projektit me prioritetet e Qeverisë Shqiptare.

Komiteti Teknik mblidhet në çdo rast sipas nevojës me kërkesë të njërit prej anëtarëve të Komitetit.

Neni IX

### **Raportimi dhe Informacioni**

Raportet e ecurisë do të përgatiten nga Partneri Zbatues çdo 6 muaj.

Të dyja Palët do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën mbi çdo situatë të ngritur që mund të ketë lidhje me zbatimin e Projektit.

Neni X

### **Monitorimi dhe Vlerësimi**

SDC do të mbikëqyrë zbatimin e Projektit.

Neni XI

### **Prokurimi**

SDC do t'i besojë zbatimin e projektit Kompanisë Ecorys. Ecorys është përzgjedhur nëpërmjet një tenderi të hapur ndërkombëtar nga një komitet vlerësimi i përbashkët i SDC, ADA-s dhe Qeverisë së Shqipërisë në përputhje me rregullat zvicerane.

Parimisht, organizata zbatuese është përgjegjëse

për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punimet e ndërtimit të nevojshme për zhvillimin e projektit, duke zbatuar parimet e një konkurrence të ndershme (të lirë dhe të barabartë) midis ofruesve të ndryshëm potencialë, në mënyrë që të arrihet efikasitet në përdorimin e fondeve publike.

Organizata zbatuese do të nënshkruajë çdo nënkontraktim në përputhje me rregullat zvicerane ashtu siç shprehen në kontratën që mund të nënshkruhet ndërmjet saj dhe SDC-së. Në rastet kur organizata zbatuese do i japë grante institucioneve shqiptare, të cilat nga ana e tyre ofrojnë mallra dhe shërbime, këto institucione do të nënshkruajnë çdo nënkontraktim në bazë të rregullave shqiptare.

Neni XII

### **Mallrat**

1. Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, mallrat e përfituara nga fondet e SDC-së për përdorim të Projektit do të qëndrojnë në dispozicion të pakufizuar të Projektit dhe nuk do të devijohen nga Projekti pa një miratim paraprak me shkrim nga Ambasada Zvicerane.

2. Nëse për ndonjë arsye Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara përmes kontributit zviceran do të vendoset me shkrim nga Palët. Në këtë rast, SDC nuk merr asnjë përgjegjësi të çfarëdo lloji në lidhje me mallrat e lartpërmendura.

3. Në fund të Projektit, të dyja Palët duhet të bien dakord me shkrim mbi pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar me fondet e Projektit.

Neni XIII

### **Përfundimi i Marrëveshjes**

1.1 Secila Palë ka të drejtë të përfundojë Marrëveshjen aktuale përmes një njoftimi me shkrim gjashtë muaj përpara përfundimit.

1.2 Nëse njëra nga Palët gjykon se Marrëveshja aktuale nuk mund të arrihet më ose që Pala tjetër nuk po përmbush detyrimet e saj, Pala tjetër do të ketë të drejtën të anulojë ose përfundojë Marrëveshjen aktuale, duke i dhënë njoftim me shkrim tre muaj para. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo Palë mund të përfundojë Marrëveshjen aktuale me efekte të menjëhershme në rast të ndonjë shkeljeje të konsiderueshme të Marrëveshjes. Shkelje e konsiderueshme nënkupton shkelje të



rëndë të një prej objektivave të rëndësishme të marrëveshjes aktuale.

1.3 Në rast se ngjarjet nga forca madhore (katastrofa natyrore etj) pengojnë zbatimin e Marrëveshjes, secila Palë mund të përfundojë Marrëveshjen që hyn në fuqi që nga momenti kur bëhet i pamundur vazhdimi i saj.

2. Në rast të një përfundimi të parakohshëm të Marrëveshjes aktuale ose në fund të Projektit, çdo fond i pashpenzuar i ofruar brenda strukturës së Projektit, do t'i kthehet SDC-së.

#### Neni XIV

### Modifikimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim ose ndryshim i Marrëveshjes aktuale duhet të bëhet me shkrim me pëlqimin e të dyja Palëve.

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose aplikimin e dispozitave të Marrëveshjes aktuale do të zgjidhen nëpërmjet negociatave diplomatike ndërmjet Palëve.

#### Neni XV

### Dispozitat e Përgjithshme

Brenda strukturës së kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk duhet të kërkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime të çfarëdo lloji natyre. Ato nuk duhet të pranojnë ndonjë kërkesë të tillë. Çdo sjellje korruptuese ose e paligjshme nënkupton një shkelje të rëndë të marrëveshjes aktuale dhe justifikon përfundimin e saj, si dhe/ose marrjen e masave korrigjuese në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm.

Bazuar në ecurinë e Projektit dhe në rezultatet e vlerësimit, të dyja Palët Kontraktuese do të vendosin nëse dhe në cilën formë do të vazhdojnë bashkëpunimin përtej vitit 2018.

#### Neni XVI

### Shtojcat

Përshkrimi i Projektit (Shtojca 1) përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni XVII

### Kohëzgjatja dhe efikasiteti

Marrëveshja aktuale mbulon periudhën prej 1 prillit 2017 deri në 30 shtator 2018.

Ajo do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Kjo Marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe.

Palët e mëposhtme konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të përpiluar në Berne më 31 Mars 2017.

Në emër të Këshillit të  
Ministrave të Republikës së  
Shqipërisë:  
Eglantina Gjermeni  
Ministër  
Ministria e Zhvillimit  
Urban

Në emër të Konfederatës  
Zviceriane:  
Manuel Sager  
Ambasador  
Drejtor i Përgjithshëm i  
Agjencisë Zviceriane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim

Përshkrimi i projektit: Programi i zhvillimit rajonal për Shqipërinë, Faza 3

#### 1. Orientim strategjik

##### 1.1 Konteksti në Shqipëri

Shqipëria është një vend me të ardhura mesatare, dhe që është në tranzicion prej 25 vitesh që prej rënies së komunizmit dhe përfundimit të izolimit. Vendi po kalon në një proces shtetformimi. Pavarësisht rritjes ekonomike të qëndrueshme gjatë viteve të fundit, vendi vazhdon të ketë një prej niveleve më të larta të varfërisë në Evropë me 14.3% të popullsisë që konsiderohet si e varfër.<sup>1</sup>

Varfëria është bërë një fenomen si urban ashtu edhe rural. Vendi është orientuar drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian (BE) dhe mori statusin e vendit kandidat në vitin 2014. Që prej vitit 2013 qeveria ka ndërmarrë një sërë reformash ambicioze: Reforma territoriale dhe administrative (RTA) ristrukturoi nivelin e parë të qeverisë, ku përmes strategjisë ndërsektoriale mbi decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015 - 2020 përgatiti terrenin për rritjen e autonomisë së njësive të qeverisjes vendore për të marrë më shumë funksione dhe fonde në të ardhmen.

Qeveria po përqendrohet njëkohësisht edhe në një tjetër reformë madhore, atë të zhvillimit rajonal (ZHR). Pabarazitë janë shumë të mëdha sidomos ndërmjet Tiranës dhe pjesës tjetër të vendit. Ndërkohë që shërbimet, ndërtimet, popullata dhe administrata janë të përqëndruara kryesisht në Tiranë, burimet e pashfrytëzuara të potencialeve ekonomike dhe mungesa e ofrimit të shërbimeve gjenden në zonat e neglizhuara dhe periferike. Prandaj neglizhimi i këtyre zonave, migrimi i brendshëm drejt Tiranës, si edhe migracioni jashtë

<sup>1</sup> Anketa për matjen e standardit të jetesës 2012.



vendit ndikojnë negativisht në vend. Në vitin 2015 rreth 60 000 shqiptarë u larguan nga vendi drejt Evropës Perëndimore. Investimet dhe fondet publike shpërndahen në mënyrë të fragmentuar në mbarë vendin, pa pasur një strategji të qartë që t'i ofrientojë ato. Prandaj po hartohet një axhendë rajonale shumësektoriale zhvillimi për të trajtuar pabarazitë ndërmjet rajoneve, dhe brenda tyre.

Reforma ZHR mori një hov të ri në vitin 2015: paralelisht me nivelin ekzistues administrativ të qarkut (njësi të ndërmjetme)<sup>2</sup>, qeveria e ndau vendin në katër zona menaxheriale rajonale (pra rajone zhvillimi); gjithashtu ngriti gjashtë agjenci që promovojnë zhvillimin rajonal.<sup>3</sup> Ndërkohë që termi "rajonal" mund të përdoret lehtësisht dhe mund të përcaktojë zona të ndryshme, në këtë kontekst termi përdoret për katër zona menaxheriale rajonale, ashtu siç përcaktohet nga qeveria.

Që prej vitit 2015, reforma për ZHR po mbështetet nga SDC dhe GIZ përmes asistencës teknike (faza tranzitore) deri në fundit të vitit 2016 ekipi i ekspertëve hartoi një dokument politikash në formë drafti, një projektligj për ZHR një analizë strategjike mbi rajonet, si edhe propozime për kornizën financiare. Objektivi i ZHR, ashtu siç është i shprehur aktualisht në projektligj, pasqyron një kombinim qasjesh përmes të cilave synohet të ulen pabarazitë në vend përmes promovimit të rritjes ekonomike. Synimi i reformës është të rritet efikasiteti i investimeve publike për zhvillimin ekonomik dhe social, si edhe për të ofruar financime të parashikueshme dhe të qëndrueshme për projektet zhvillimore që kanë dimensione të qarta të zhvillimit rajonal. Ajo krijon partneritete me palë të ndryshme të interesit dhe synon të bashkërendojë politikat e ZHR të Shqipërisë me politikat rajonale të BE (politikat e kohezionit të BE/EU Cohesion Policy). Kjo do ta përgatisë Shqipërinë për më shumë fonde nga BE. Ndërsa janë përcaktuar në përgjithësi elementet bazë, politikat kërkojnë mbështetje të madhe për t'i zbatuar ato në praktikë në nivel kombëtar dhe nënkombëtar.

1.2 Bashkërendimi strategjik dhe rëndësia e ndihmesës

Faza e re e projektit është e bashkërenduar me strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim të Shqipërisë (SKZHI) 2015 - 2020, e cila përcakton objektivat strategjike dhe zhvillimin rajonal si edhe është në linjë me projektligjin e ZHR dhe me strategjinë e decentralizimit në vend. Është gjithashtu tërësisht e bashkërenduar me parimet e qeverisjes së mirë të përcaktuara në Dokumentin e Bashkëpunimit Zviceran Ndërkombëtar 2017 - 2020, me Strategjinë aktuale për Bashkëpunim Zviceran për Shqipërinë 2014 - 2017.

### 1.3 Grupi i synuar

*Përfituesit e drejtpërdrejtë* të ndërhyrjes janë Ministria e Zhvillimit Urban në Shqipëri, dhe strukturat e reja të ngritura për zhvillimin rajonal; katër Agjencitë e Zhvillimit Rajonal (AZHR) dhe Agjencia Rajonale e Zhvillimit Rajonal.<sup>4</sup> Fillimisht bashkitë do të trajtohen parë nga perspektiva e bashkëpunimit midis bashkive. Organizata joqeveritare dhe ato që përfaqësojnë bizneset do të përfshihen shumë në programin e ZHR, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve. *Përfituesit përfundimtarë* janë qytetarët e Shqipërisë që do të përfitojnë nga politika dhe investime të bashkërenduara më mirë të qeverisë duke marrë në konsideratë pabarazitë rajonale. Gjithashtu, qytetarët do të përfitojnë nga projektet e ZHR, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë synojnë të përmirësojnë gjendjen sociale dhe ekonomike të popullatës.

### 1.4 Afatet kohore

Ndërhyrja e propozuar planifikon një fazë 18 mujore që prej 1.4.2017 deri më 30.9.2017 (faza tre) do të ketë një fazë të katërt për vitet 2018 - 2022. Në bazë të një analize në vitin 2020 do të merret vendimi nëse dy vitet e fundit do të trajtohen si fazë daljeje, ose nëse do të ketë një fazë daljeje nga 2023 - 2026, në varësi të ecurisë që ka pasur Shqipëria drejt integritimit në BE.

### 2. Objektivat

Duke qenë e bashkërenduar me SKZHI, Strategjia e Bashkëpunimit Zviceran dhe politikat (në formë drafti) të ZHR, do të mbahet parasysh *synimi i përgjithshëm*.

Pabarazitë në Shqipëri duke mbështetur zhvillimin e rajoneve të fuqishme që do të përforcojnë potencialet e tyre dhe do të ofrojnë

<sup>2</sup> Reforma nuk trajton nivelin administrativ ndërmjet nivelit kombëtar dhe vendor.

<sup>3</sup> Agjencia Kombëtare e Zhvillimit Rajonal (AKZHR), katër agjencitë e zhvillimit rajonal (AZHR) dhe Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Rajonal (ZHER).

<sup>4</sup> GIZ po e përqendron mbështetjen e tij në aspektin ekonomik të Zhvillimit Rajonal dhe për pasojë po mbështet Agjencinë e Zhvillimit Ekonomik Rajonal (ZHER)



kushte më të mira sociale dhe ekonomike për qytetarët e tyre.

- *Rezultati 1:* Qveria qendrore përcakton bashkërendon dhe zbaton me sukses kornizën ligjore dhe institucionale për zhvillimin rajonal.

- *Rezultati 2:* Institucionet e reja për zhvillimin rajonal përdorin në mënyrë efikase dhe strategjike fondet e shtuara për zhvillimin e rajoneve përmes një qasjeje me bazë partneritetin.

- *Rezultati 3:* Kushtet sociale dhe ekonomike për qytetarët që jetojnë në Shqipëri janë përmirësuar përmes zbatimit të projekteve të zhvillimit rajonal të mbështetura në nevojat dhe prioritetet rajonale.

Projekti trajton si nivelet kombëtare edhe ato rajonale. Në *nivel kombëtar (rezultati 1)* mbështetja për reformën për ZHR do të vazhdojë bazuar në rezultatet e fazës tranzitore (korniza ligjore dhe e politikave) siç mund të jenë hartimi i legjislacionit dytësor (korniza ligjore), ndjekja lidhur me strukturën e re financiare (modalitete të reja për Fondin e Zhvillimit Rajonal), mbështetje (vertikale dhe horizontale) për bashkërendim dhe fusha të tjera, në bazë të kërkesave nga qeveria qendrore. Për *rezultatit 2* mbështetja do të jetë kryesisht për strukturat e reja të krijuara, si edhe për institucione të tjera të përfshira në ZHR, siç mund të jenë palët e interesuara rajonale dhe vendore. Këto përfshijnë: 1. Forcimin e sistemeve institucionale të agjencive të ZHR që do të krijohen gjatë vitit të tyre të parë të funksionimit (ngritja e kapaciteteve, ngritja e institucioneve, qasjet përmes pjesëmarrjes). 2. Hartimin e Programeve Operacionale të Zhvillimit Rajonal (POZHR) përmes një mënyre me pjesëmarrje; shtyllat e objektivave, indikatorëve dhe prioritetëve të katër rajoneve; 3. Sigurimi i një qasjeje partneriteti duke integruar qeverinë vendore, shoqërinë civile, sektorin privat në programimin, monitorimin dhe projektet e ZHR. *Rezultati 3* i referohet zbatimit të POZHR: Grantet për projektet pilote janë identifikuar, kanalizuar dhe zbatuar përmes agjencive të reja të zhvillimit rajonale, si një mënyrë që këto institucione të ushtrjnë funksionet dhe kapacitetet e tyre. Hipoteza e ndikimit të projektit është se duke mbështetur qeverisjen e Zhvillimit Rajonal - të përbërë nga institucione të përcaktuara mirë dhe nga kuadër ligjor dhe nga kapacitete menaxheriale; si edhe partneriteti me palë të interesuara rajonale dhe vendore-të gjitha rajonet e Shqipërisë do të jenë në gjendje të krijojnë më shumë investime dhe

t'i përdorin ato bazuar në nevojat dhe prioritetet e tyre. Përmes kësaj ata do të ofrojnë kushte më të mira sociale dhe ekonomike për qytetarët e tyre. Struktura e re ligjore dhe institucionale e ZHR do të rrisë në mënyrë të ndjeshme alokimet financiare drejt iniciativave rajonale, duke forcuar në këtë mënyrë aftësinë e institucioneve rajonale dhe vendore në mënyrë që të hartojnë në mënyrën e duhur ZHR në fushat e tyre. Projekti do të mbështesë gjithashtu procesin e demokratizimit duke fuqizuar qytetarët të marrin pjesë në zhvillimin e rajonit të tyre.

### 3. Strategjia e ndërhyrjes

Faza tranzitore (PZHR 2) ofroi një koncept /dokument në formën e një drafti projekti ku përfshihet një përmbledhje për të çuar përpara investimet në ZHR në Shqipëri, paraqiste kontekstin, elementet mbështetëse/penguese për ndryshim, zhvillimet aktuale, vlerësimet e riskut dhe pika të mundshme hyrjeje për ndërhyrje.

Ndërhyrja mbulon nivelet e mëposhtme:

- Makro - zhvillimi i legjislacionit dhe politikave kombëtare ZHR

- Meso - mbështetje për strukturat e reja ZHR, si edhe planeve/programeve

- Mikro - financimi i projekteve ZHR që përfshin bashkitë dhe palët e interesuara vendore

Ndërhyrja do të përqendrohet në dy qasje: 1. Asistencë teknike dhe rritje të kapaciteteve për palët e ndryshme të interesuara të lidhura me ZHR dhe 2. Grante për projektet e ZHR.

Faza 2017 deri 2018 do të përdoret për të ngritur njësinë e zbatimit të projektit, për të ofruar asistencë teknike dhe mbështetje për kapacitetet në nivel rajonal dhe kombëtar, për të forcuar qasjet asistencë teknike dhe mbështetje për kapacitetet në nivel rajonal dhe kombëtar, për të forcuar qasjet me partneritet dhe mekanizmat pjesëmarrës përkatës. Idea ashtu siç është pasqyruar në draftpolitikat, është që të ngrihen borde komitetesh/partneriteti për Agjencinë Kombëtare të Zhvillimit Rajonal, si edhe për katër Agjencitë e Zhvillimit Rajonal, të cilat do të mbikëqyrin dhe monitorojnë zbatimin e Programeve Operacionale të Zhvillimit Rajonal.

Për më tepër, funksionimi dhe kriteret e pagesave për grantet do të përcaktohen në mënyrë më të detajuar; gjatë fazës së parë, do të ndërmerren projekte ndërmjet bashkive dhe rajoneve. Për fazën 4 të projektit, do t'i kushtohet me shumë vëmendje granteve.



Duke mbajtur parasysh që përkushtimi ndaj reformës prej QSH është shumë i lartë, kjo përbën mundësi për Zvicrën për të luajtur një rol drejtues për reformën. Zvicra është e pozicionuar mirë për të mbështetur ZHR duke qenë se është një prej donatorëve më aktivë në vend për decentralizimin. Gjatë dy fazave të mëparshme (PZHR 1, PZHR 2) SDC mund të bazohet në përvojat e mëparshme të ndërhyrjeve për ZHR. E fundit, por jo nga rëndësia, qeveria i ka kërkuar në mënyrë specifike Zvicrës të ketë një rol drejtues në mbështetjen e reformës ZHR.

*Çështjet ndërsektoriale* (përkatësia gjinore, qeverisja e mirë) do të mbulohen tërësisht për t'u siguruar që projekti kontribuon ndaj aspekteve horizontale të zhvillimit. Të dhënat, kur janë të disponueshme do të zbrërthehen dhe analizohen nga perspektiva të balancës së përkatësisë gjinore dhe kontekstit social. Integrimi i plotë i tematikave të tërthorta do të jetë përgjegjësi e kontraktorit të asistencës teknike dhe duhet të partaqitet në ofertën teknike.

#### 4. Burimet

Ekipi zbatues u përzgjedh përmes një tenderi ndërkombëtar të hapur, së bashku me ADA dhe Qeverinë e Shqipërisë. Kompania Ecorys është fituesi i procesit të prokurimit. Ndërkohë që ADA ishte donatori drejtues në PZHR 1 (2010-2015) në këtë fazë SDC do të jetë drejtuesja. Për shkak të reformës, faza e tretë do të marrë një drejtim të ri, dhe kjo është arsyeja se përse tenderi i hapur përcaktoi një agjenci zbatuese të re. ADA do të bashkëfinancojë projektin. Do të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi e deleguar midis SDC dhe ADA. Donatorë të tjerë mund t'i bashkëngjiten projektit në një fazë të mëvonshme (sidomos për skemën e granteve). Sasia e përgjithshme për fazën 3 (2017 - 2018; 18 muaj) të projektit është 3'445'000 CHF, e ndjekur nga faza 4 prej 4-vjetësh (2018 - 2022) me rreth 7'575'000 CHF, nëse do të miratohet nga organet kompetente të ADA dhe SDC.

#### 5. Monitorimi dhe drejtimi

Monitorimi i drejtpërdrejtë i projektit do të bëhet nga ekipi zbatues i Ecorys. Projekti do të zbatohet nën orientimin e komitetit drejtues të projektit, i bashkëdrejtuar nga SDC dhe qeveria.

## LIGJ Nr. 67/2017

### **PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR PROJEKTIN “RUAJTJA E AGROBIODIVERSITETIT NË SHQIPËRINË RURALE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Ruajtja e agrobiodiversitetit në Shqipërinë rurale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10274, datë 4.5.2017  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

Nr. 4436  
Tiranë më 30.3.2017

E nderuar zonja Ambasadore

Kam nderin t'i referohem notës tuaj të datës 26 shtator 2016, nr. Wi 445 TZ 123, e cila citon:

Zoti Ministër,

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke ju referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 dhe premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë si dhe në zbatim



të marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik mes Gjermanisë dhe Shqipërisë të datës 21 tetor 1988, t'ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi Bashkëpunimin Teknik:

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do ta mbështesin së bashku projektin “Ruajtja e agrobiodiversitetit në Shqipërinë rurale”, nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për shtimin e fondeve në projektin në fjalë, kontribute personeli dhe materiale si dhe eventualisht kontribute financimi prej gjithsej 500 000 Euro (me fjalë: pesë qind mijë euro). Ajo do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset, që institucioni i ngarkuar prej tij me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e lartpërmendur.

5. Hollësitë e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në një kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, i cili do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Kontrata do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy qeveritë bien dakord për këtë.

7. Fondet e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat – pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 – do të mbarojë më datë

31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licencat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksa të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy Qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoni, zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

E nderuar zonja Ambasadore,

Kam nderin të konfirmoj në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përsa është propozuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe bie dakord që nota e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo notë në përgjigje të saj do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga pala gjermane të njoftimit të shkruar nga pala shqiptare, për përfundimin e procedurave të nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Pranoni zonja Ambasadore sigurimet e konsideratës më të lartë.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME  
**Ditmir Bushati**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 308 lekë